



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

**REPUBLIKA E MAQEDONISË
SË VERIUT**

**ZGJEDHJET PRESIDENCIALE
21 prill dhe 5 maj 2019**

**Misioni i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar**



Varshavë
21 gusht 2019

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALËNDERIME.....	3
III.	SFONDI.....	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE	5
V.	ADMINISTRATA I ZGJEDHORE.....	6
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	10
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	12
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE.....	13
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	16
X.	MEDIAT	19
A.	AMBIENTI MEDIATIK.....	19
B.	KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT	20
C.	GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAVE	21
XI.	ANKESAT DHE APELIMET.....	22
XII.	VËZHGESIT CIVILË DHE NDËRKOMBËTARË.....	24
XIII.	DITA E ZGJEDHJEVE.....	25
A.	RRETHI I PARË	25
B.	RRETHI I DYTË.....	27
XIV.	ZHVILLIMET PAS ZGJEDHJEVE.....	28
XV.	REKOMANDIMET	29
A.	REKOMANDIMET PRIORITARE.....	29
B.	REKOMANDIME TË TJERA.....	30
	ANEKSI I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE	33
	ANEKSI I: LISTA E VËZHGESVE NË MISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE	34
	RRETH ODIHR-IT.....	39

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
ZGJEDHJET PRESIDENCIALE
21 prill dhe 5 maj 2019

Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) dërgoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet presidenciale që u mbajtën më 21 prill të vitit 2019. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në vend për të vëzhguar rrethin e dytë të zgjedhjeve që u mbajt më 5 maj. Për të dy ditët e zgjedhjeve, MVZ-së së ODIHR-it iu bashkuan delegacionet nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të formuar Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin e vendit.

Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake që u publikua më 22 prill nxori përfundimin se "votuesit kishin mundësi të bëjnë zgjedhje në bazë të informatave midis vizioneve konkurruese politike, me fushata ku u respektuan liritë themelore për tubim dhe shprehje. Përkundër disa sfidave teknike, zgjedhjet ishin përgjithësisht të administruara mirë. Mangësitë rregullatore u trajtuan pjesërisht përmes marrëveshjeve politike ndërpartiake, por mbetet nevoja për ta përfunduar reformën e legjislacionit zgjedhor të filluar më parë. Dita e zgjedhjeve ishte paqësore, e rregullt dhe transparente dhe përgjithësisht u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e MNVZ-së".

Pasi asnjëri nga tre kandidatët nuk fitoi numrin e nevojshëm të votave për t'u zgjedhur në rrethin e parë, më 5 maj u mbajt rrethi i dytë. Deklarata e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake që u publikua më 6 maj nxori përfundimin se "në balotazhin e administruar mirë të zgjedhjeve presidenciale, respektimi i vazhdueshëm i lirive themelore u mundësoi votuesve të bëjnë zgjedhje në bazë të informatave midis kandidatëve. Mangësitë në rregullat e fushatës ishin të dukshme edhe në rrethin e dytë, gjë që i pasqyroi mangësitë më të gjera në ligjin zgjedhor. Transparenca e financimit të fushatës u zvogëlua nga raportimi jo i plotë. Dita e zgjedhjeve kaloi pa pengesa, ndërsa procedurat kryesore përgjithësisht u ndoqën në mënyrë transparente". Edhe pse u plotësua në këto zgjedhje, kriteri për pjesëmarrje të votuesve prej 40 për qind për rrethin e dytë krijoi mundësi për cikle të zgjedhjeve të përsëritura.

Korniza ligjore përgjithësisht paraqet një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Mirëpo, Kodi Zgjedhor nuk i rregullon në mënyrë adekuate disa elemente të rëndësishme të fushatës. Në mungesë të rregullave të qarta për kandidatët presidencialë, këto elemente u rregulluan në bazë të marrëveshjeve ndërpartiake gjë që nuk ofroi mundësi të barabarta për të gjithë garuesit. Shumë rekomandime të mëparshme të ODIHR-it në lidhje me kornizën ligjore mbeten të patrajtuara, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me të drejtën e kandidimit, të drejtat e votës së personave me aftësi të kufizuara mendore, shqyrtimin e detajuar të raporteve të përkohshme për financimin e fushatës, dhe bazën ligjore për të parashtruar ankesa. Në përgjithësi, mangësitë rregullatore e dëmtuan qartësinë ligjore dhe e nënvizuan rëndësinë e përfundimit të reformës legjislative.

Zgjedhjet u administruan nga administrata me tre nivele, e përbërë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), Komisionet Zgjedhore Komunale, dhe Këshillat Zgjedhorë. Administrata zgjedhore i përmbushi funksionet e saj kryesore në mënyrë profesionale, funksionoi në mënyrë transparente dhe të paanshme dhe e gëzoi besimin e shumicës së palëve të interesuara gjatë gjithë procesit. Transparenca

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Përkthime jozyrtare janë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

dhe efikasiteti i KSHZ-së, në disa raste u pengua nga defekte teknike të sistemeve të tij të informacionit dhe të komunikimit, të cilat gjithashtu ngritën pyetje në lidhje me sigurinë e TIK-ut. KSHZ-ja bëri edukimin e votuesve në mediat transmetuese dhe në rrjetet sociale, në disa gjuhë dhe me interpretim në gjuhën e shenjave, por shtrirja dhe dukshmëria e kësaj fushate ishte e kufizuar.

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve, i cili bazohet në informatat nga regjistrat civilë dhe regjistrat e tjerë kombëtarë. Votuesit, të cilëve u kishte skaduar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim para ditës së zgjedhjeve, u hoqën automatikisht nga listat e votuesve, që paraqitpengesë të paarsyeshme për të ushtruar të drejtën e votës, që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Megjithëse palët e interesuara nuk shprehën shqetësime të mëdha për saktësinë e regjistrit të votuesve, mospërputhjet ndërmjet bazave të të dhënave të ndryshme shtetërore dhe formatet e ndryshme të të dhënave vazhduan të paraqesin sfida.

KSHZ-ja në mënyrë inkluzive, i regjistroi të tre kandidatët që arritën ta mbledhin numrin e kërkuar të nënshkrimeve për mbështetje nga votuesit për emërimin e tyre, duke përfshirë një grua dhe një kandidat shqiptar etnik. Edhe pse u regjistruan si kandidatë jo-partiakë, secili nga tre kandidatët u mbështet nga parti politike para mbledhjes së nënshkrimeve dhe regjistrimit, dhe përdorën simbole partiake për identifikim në fletëvotim. Megjithëse ishin parashtruar disa ankesa, shumica e bashkëbiseduesve nuk shprehën shqetësime për procesin e përgjithshëm të regjistrimit të kandidatëve.

Fushata u zhvillua në ambient të qetë dhe paqësor. Liritë themelore për tubim dhe shprehje u respektuan dhe pjesëmarrësit në zgjedhje ishin në gjendje të zhvillojnë fushatën lirshëm dhe pa pengesa. Për t'u veçuar në këto zgjedhje ishte fakti se partia në pushtet dhe disa parti etnike-shqiptare e mbështetën bashkërisht një kandidat presidencial, dhe se kandidatët iu drejtuan bashkësive të ndryshme etnike. Liderët partiak spikatën me prezencën e tyre në aktivitetet e fushatës, pavarësisht nga fakti se kandidatët nuk ishin zyrtarisht të lidhur me partitë politike. Në përgjithësi, funksionarët shtetërorë u duk se ishin të kujdesshëm që të bëjnë dallim të qartë ndërmjet detyrave të tyre zyrtare dhe aktiviteteve politike, dhe të mos përdorin burime shtetërore në fushatë. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, politizimi i emërimeve në sektorin publik krijon pritshmërinë se punonjësit duhet t'i mbështesin partitë në pushtet, madje edhe në mungesë të udhëzimeve të qarta për këtë.

Gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore, vetëm 4 nga 26 ministra qeveritarë ishin gra dhe vetëm 6 nga 81 kryetarë të komunave ishin gra. Edhe pse një kandidate ishte grua, gratë nuk u paraqitën aq shpesh si folëse në fushatës dhe pjesëmarrja e grave në ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it ishte e ulët në mënyrë disproporcionale. Dy kandidatë ngritën çështje që lidhen me pjesëmarrjen e grave dhe barazinë gjinore. Gratë ishin të përfaqësuara mirë në administratën zgjedhore.

Rregullat e financimit të fushatës përcaktojnë kritere të përgjithshme për zbulimin e shpenzimeve dhe raportimin për financimin e fushatës, të cilat kandidatët kryesisht i respektuan. Megjithatë, nuk kishte raportim të njëtrajtshëm të shpenzimeve të kandidatëve dhe rregullat e raportimit nuk janë të qarta për një garë në dy rrethe dhe nuk e trajtojnë zhvillimin e fushatës nga palët e treta. Së bashku me kompetencat dhe burimet e kufizuara të institucioneve të përfshira në mbikëqyrjen e financimit të fushatave, uzvogëlua transparenca e financimit të fushatës dhe efektiviteti i mbikëqyrjes.

Transmetuesi publik dhe shumica e mediave të monitoruara ofruan mbulim të paanshëm, që në tërësi, iu mundësoi votuesve të marrin vendim në bazë të informatave. Organi rregullator i mediave i përmbushi detyrimet e tij ligjore dhe bëri monitorimin e mbulimit mediatic të fushatës. Mediat prezantuan informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që i mbështetën ata, nëpërmjet programeve të ndryshme, reklamave të paguara dhe debateve televizive. Mënyra e re, e sapo futur, e kompensimit të reklamave politike nga shteti kishte për qëllim të promovojë qasje më të madhe në media për të gjithë garuesit.

Shumica e ankesave në lidhje me zgjedhjet trajtohen nga KSHZ-ja, ndërsa Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) i trajton ankesat në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore. KSHZ-ja i shqyrtoi ankesat e periudhës para zgjedhjeve brenda afatit ligjor, por vendimet nuk kishin arsytetim thelbësor. Ankesat për parregullsitë e ditës së zgjedhjeve u trajtuan nga KSHZ-ja në mënyrë transparente dhe efektive pas të dy rretheve. Pavarësisht nga kjo, kufizimet për atë se kush ka të drejtë të parashtrijë ankesa dhe apelime nuk mundësojnë disponueshmëri të plotë të mjeteve ligjore.

Të dyja ditët e zgjedhjeve ishin të qeta dhe të administruara mirë. Vlerësimi i përgjithshëm i votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve ishte pozitiv, me ç'rast u ndoqën procedurat kryesore. Në të dyja rrethet zgjedhore disa votues me të drejtë vote nuk gjendeshin në listat e votuesve dhe vëzhguesit panë raste të votimit familjar dhe grupor, të cilët kryesisht ndikojnë në mundësinë e grave për të hedhur votën e tyre lirisht dhe në fshetësi. Në rrethin e dytë MNVZ-ja vërejti indikacione të qarta të blerjes së votave. KSHZ-ja i publikoi rezultatet paraprake në ueb-faqen e saj pak kohë pas mbylljes së vendvotimeve, të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve, gjë që mundësoi transparencë. Të gjithë kandidatët i pranuan rezultatet e zgjedhjeve dhe atmosfera pas zgjedhjeve ishte paqësore.

Ky raport ofron një sërë rekomandimesh për mbështetjen e përpjekjeve të Maqedonisë së Veriut në afrimin e zgjedhjeve me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me nevojën e vazhdueshme për reformim të legjislacionit zgjedhor dhe forcim të kapaciteteve të organeve mbikëqyrëse, veçanërisht në lidhje me fushatën dhe financimin e fushatës. ODIHR-i është i gatshëm t'u ndihmojë autoriteteve që të përmirësojnë procesin zgjedhor dhe të trajtojnë rekomandimet e këtij raporti dhe raporteve të mëparshme.

II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i vëzhguar zgjedhjet presidenciale të 21 prillit të vitit 2019 dhe në përputhje me mandatin e saj, ODIHR-i më 11 mars dërgoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e udhëhequr nga Corien Jonker, përfshinte 11 ekspertë të vendosur në Shkup dhe 18 vëzhgues afatgjatë të cilët u shpërndanë në mbarë vendin nga 20 marsi. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në vend për të vëzhguar rrethin e dytë të zgjedhjeve që u mbajt më 5 maj. Misioni qëndroi në Maqedoninë e Veriut deri më 17 maj për të ndjekur zhvillimet pas zgjedhjeve.

Për të dy ditët e zgjedhjeve, MVZ-së së ODIHR-it iu bashkuan delegacionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP e OSBE-së) dhe të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) për ta formuar Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). Znj. Sereine Mauborgne u emërua nga kryesuesi i OSBE-së si Koordinatore e posaçme dhe udhëheqëse e Misionit Vëzhgues Afatshkurtër të OSBE-së. Z. Reinhold Lopatka e udhëhoqi delegacionin e AP të OSBE-së. Znj. Marie-Christine Dalloz e udhëhoqi delegacionin e APKE-së.

Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë u shpërndanë 240 vëzhgues nga 38 vende, duke përfshirë 189 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të caktuar nga ODIHR-i, si dhe një delegacion 40-anëtarësh nga AP-ja e OSBE-së dhe një delegacion 12-anëtarësh nga APKE-ja, 43 për qind e të cilëve ishin gra.² Hapja u vëzhgua në 93 vendvotime, ndërsa votimi në 979 vendvotime anëmbanë vendit. Numërimi i votave u vëzhgua në 87 vendvotime, ndërsa nxjerrja e rezultateve në 69 Këshilla Zgjedhorë Komunalë (KZK). Votimi i hershëm u vëzhgua në 13 vendvotime speciale më 20 prill. Për balotazhin që u mbajt

² Gratë përbënin 36 për qind të ekspertëve në ekipin kryesor të MVZ-së së ODIHR-it dhe 39 për qind të vëzhguesve afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it.

më 5 maj u shpërndanë 172 vëzhgues nga 32 vende, duke përfshirë 156 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të caktuar nga ODIHR-i, si dhe një delegacion 11-anëtarësh nga AP-ja e OSBE-së dhe një delegacion 5-anëtarësh nga APKE-ja. Hapja u vëzhguar në 64 vendvotime, ndërsa votimi në 688 vendvotime anembanë vendit. Numërimi i votave u vëzhguar në 71 vendvotime ndërsa nxjerrja e rezultateve në 61 KZK. Votimi i hershëm u vëzhguar në 13 vendvotime speciale më 4 maj.

MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe legjislacionin e vendit. Ky raport përfundimtar pason pas dy Deklaratave për gjetjet dhe përfundimet paraprake, që u publikuan në konferencat për shtyp që u mbajtën në Shkup më 22 prill dhe 6 maj.³

MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për ndihmën e tij. MVZ-ja e ODIHR-it po ashtu përcjell falënderime edhe institucioneve të tjera, partive politike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, për këmbimin e pikëpamjeve të tyre, si dhe përfaqësuesve rezident të bashkësisë ndërkombëtare dhe Misionit të OSBE-së në Shkup për bashkëpunimin e tyre.

III. SFONDI

Më 8 shkurt të vitit 2019, kryetari i Kuvendit i shpalli zgjedhjet presidenciale për më 21 prill. Kryetari i mëparshëm i vendit, Gjorge Ivanov, për herë të parë u zgjodh në vitin 2009, i mbështetur nga partia e atëhershme në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), ndërsa u rizgjodh për mandatin e dytë dhe të fundit në vitin 2014. Kriza e zgjatur politike në vitet në vijim çoi në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016, të cilat në fund rezultuan me qeveri të re të udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) në koalicion me partinë kryesisht të shqiptarëve etnikë, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI), e cila më parë ka qenë në koalicion me VMRO-DPMNE-në.⁴

Partitë tradicionalisht kanë garuar për vota kryesisht brenda bashkësive të tyre etnike, ndërsa koalicionet në pushtet janë formuar përtej ndarjes etnike, duke i përfshirë partitë etnike shqiptare. Megjithatë, në zgjedhjet komunale të vitit 2017, LSDM-ja dhe BDI-ja i mbështetën kandidatët e njëri-tjetrit në disa gara për kryetarë të komunave, dhe LSDM-ja ka bërë përpjekje për t'i tërhequr votuesit etnikë shqiptarë. Në këto zgjedhje, për herë të parë në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, një kandidat, Stevo Pendarovski, u mbështet edhe nga partitë e maqedonasve etnikë edhe nga ato të shqiptarëve etnikë: blloku politik i udhëhequr nga LSDM-ja, si dhe nga BDI-ja, Partia Demokratike Shqiptare dhe AlternAtivA.⁵ Gordana Siljanovska Davkova u mbështet nga blloku politik i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, ndërsa kandidati i tretë, Blerim Reka, u mbështet nga dy parti opozitare të shqiptarëve etnikë, Aleanca për Shqiptarët (AA) dhe BESA.⁶

Pasi asnjëri nga tre kandidatët nuk i fitoi votat e nevojshme të shumicës së votuesve të regjistruar për t'u zgjedhur në rrethin e parë, dy kandidatët që e fituan numrin më të madh të votave, z. Pendarovski dhe znj. Siljanovska Davkova, kaluan në rrethin e dytë që u mbajt më 5 maj.

³ Shih gjithashtu [raportet e mëparshme të vëzhgimit të ODIHR-it në Maqedoninë e Veriut](#).

⁴ Në koalicionin në pushtet, blloku i udhëhequr nga LSDM-ja ka 49 nga gjithsej 120 deputetë, BDI-ja - 10, AlternAtivA - 3, Partia Demokratike Shqiptare - 2 dhe Rilindja Demokratike Kombëtare -1. Blloku opozitar i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja ka 43 deputetë, Aleanca për Shqiptarët - 2 dhe BESA - 2. 8 deputetë u dëbuan nga blloku i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja pas votimit parlamentar për ndryshimet kushtetuese në vitin 2018. Dyzet e pesë deputetë janë gra, ndërsa 23 e identifikojnë veten si shqiptarë etnikë.

⁵ Z. Pendarovski më parë kandidoi për kryetar të vendit në vitin 2014, po ashtu i mbështetur nga LSDM-ja.

⁶ Besa do të thotë "besë" në shqip.

Zgjedhjet u mbajtën në kontekst të zhvillimeve të rëndësishme për ambiciet e vendit për t'u anëtarësuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe Bashkimin Evropian (BE). Pas marrëveshjes dypalëshe me Greqinë ("Marrëveshja e Prespës") në qershor të vitit 2018, dhe referendumit konsultativ në shtator, Kuvendi i miratoi ndryshimet kushtetuese në janar të vitit 2019 për ta ndryshuar emrin kushtetues të vendit në përputhje me marrëveshjen. Më 6 shkurt të vitit 2019, vendet anëtare të NATO-s nënshkruan protokollin për pranim të Maqedonisë së Veriut. Në periudhën parazgjedhore, kryeministri publikisht potencoi rëndësinë e realizimit demokratik të zgjedhjeve për avancimin e mëtejshëm të vendit drejt hyrjes në BE dhe anëtarësimit në NATO.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Kryetari i vendit zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta sipas sistemit të shumicës me mandat prej pesë vjetësh, më së shumti për dy mandate. Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë shumicën e votave të votuesve të regjistruar.⁷ Në të kundërtën, mbahet rrethi i dytë brenda dy javëve ndërmjet kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rrethin e dytë zgjidhet kandidati që ka fituar më shumë vota, me kusht që të ketë pjesëmarrje të votuesve prej së paku 40 për qind të votuesve të regjistruar. Përndryshe procesi zgjedhor do të përsëritet. Ligji nuk përcakton se kur duhet të mbahen zgjedhjet e përsëritura. Siç është theksuar më parë nga ODIHR-i dhe Komisioni i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), nuk ka garanci se në zgjedhjet e përsëritura do të ketë pjesëmarrje më të lartë të votuesve, kështu që kushti për pjesëmarrjen e votuesve në rrethin e dytë mund të çojë në cikle të zgjedhjeve të dështuara.⁸

Duhet konsideruar mundësia për rishikim të pragut të pjesëmarrjes së votuesve për zgjedhjet presidenciale për të minimizuar rrezikun e zgjedhjeve të dështuara. Korniza ligjore mund të ndryshohet për të llogaritur shumicën fituese në rrethin e parë nga numri i votave të hedhura, ndërsa kriteri për pjesëmarrje të votuesve në rrethin e dytë mund të hiqet.

Zgjedhjet presidenciale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006.⁹ Vendi është palë në instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale që janë relevante për

mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.¹⁰ Me ndryshimet e paradokohshme të Kodit Zgjedhor në vitin 2018 dhe 2019 u ndryshua përbërja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u zgjeruan kompetencat e tij, dhe u parapaja kompensimi për reklamat e paguara politike nga buxheti shtetëror. Ndryshimet ligjore

⁷ Siç është theksuar në [Mendimin e përbashkët për Kodin Zgjedhor të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#), ky prag i lartë i pjesëmarrjes (50 për qind e votuesve të regjistruar) paraqet largim nga një rregull më i zakonshëm i më shumë se 50 për qind të votave të vlefshme të hedhura në një palë zgjedhje.

⁸ Në [Mendimin e përbashkët për Kodin Zgjedhor të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#) është rekomanduar që kriteri për pragun e pjesëmarrjes në rrethin e dytë të hiqet. Shih gjithashtu [raportet e mëparshme të vëzhgimit të ODIHR-it në Maqedoninë e Veriut](#).

⁹ Korniza ligjore ndër të tjera gjithashtu përfshin, Ligjin për Partitë Politike të vitit 2004, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, Kodin Penal të vitit 1996, Ligjin për Media të vitit 2013 dhe Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike të vitit 2013, si dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

¹⁰ Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë [Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike \(KNDKP\)](#), [Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut \(KEDNJ\)](#), [Konventën e Kombeve të Bashkuara \(KB\) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#), [Konventën e OKB-së për të Drejtat e të Personave me Aftësi të Kufizuara \(KDKPAK\)](#) dhe [Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit \(KOKBKK\)](#).

u miratuan nga Kuvendi përmes një procedure të përsheptuar, edhe atë, sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, pa konsultim domethënës me palët e interesuara.¹¹

Megjithëse korniza ligjore paraqet një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, një numër rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës mbeten për t'u trajtuar, duke përfshirë edhe ato që lidhen me të drejtën e kandidimit, të drejtën e votës së personave me aftësi të kufizuara mendore, shqyrtimin e detajuar të raporteve të përkohshme financiare të fushatës dhe bazën ligjore për të parashtruar ankesa.¹² Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, përfshirë edhe KSHZ-ja, nënvizuan nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të legjislacionit zgjedhor.¹³

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor nuk i pasqyrojnë kriteret e veçanta të garave presidenciale. Për shembull, rregullat për mënyrën e ndarjes së reklamimit në media dhe hapësirës reklamuese në bilborde u referohen vetëm partive politike parlamentare të aleancave në pushtet ose atyre opozitare dhe nuk i përmendin kandidatët presidencialë.¹⁴ Ligji gjithashtu nuk i rregullon të gjitha aspektet për mbajtjen e rrethit të dytë.¹⁵ Shumica e udhëzimeve të miratuara nga KSHZ-ja për këto zgjedhje, kryesisht e përsëritën Kodin Zgjedhor dhe nuk ofruan qartësim plotësues.¹⁶ Në mungesë të rregullave të qarta, çështjet përkatëse u zgjodhën me marrëveshje politike ndërpartiake, me të cilat rregullat e Kodit Zgjedhor që vlejné për partitë politike në zgjedhje u ekstrapoluan edhe për kandidatët e pavarur në zgjedhjet presidenciale, por nuk ofruan mundësi të barabarta për të gjithë garuesit (shih po ashtu *Mediat*).¹⁷ Asnjë kandidat nuk i shprehi shqetësime MVZ-së së ODIHR-it në lidhje me këtë marrëveshje. Megjithatë, mangësitë rregullatore e dëmtuan qartësinë ligjore.¹⁸

Duhet të bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i legjislacionit zgjedhor për t'i trajtuar mangësitë e identifikuar në këtë dhe në raportet e mëparshme të ODIHR-it. Rregullat e fushatës dhe të mediave duhet ta rregullojnë garën presidenciale dhe të sigurojnë mundësi të barabarta për kandidatët. Duhet të sqarohen rregullat për rrethin e dytë. Procesi i reformës duhet të jetë publik, inkluziv dhe të kryhet në afat të mjaftueshëm kohor para zgjedhjeve të ardhshme.

V. ADMINISTRATA I ZGJEDHORE

¹¹ Paragrafi 5.8 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) i obligon vendet pjesëmarrëse t'i miratojnë ligjet "në fund të një procedure publike".

¹² Në paragrafin 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet".

¹³ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut, qeveria, në konsultim me shoqërinë civile dhe partitë politike, filloi reformën e legjislacionit zgjedhor, por këto reforma janë në pritje dhe kanë nevojë për konsultime të mëtejshme publike.

¹⁴ Si përpjekje për t'i trajtuar disa nga këto zbrazëtira në ligj, më 27 mars u miratuan disa ndryshime të imta në Kodin Zgjedhor në momentin e fundit, me të cilat në disa dispozita që kanë të bëjnë me fushatën u shtua fjala "kandidatë/t" krahas partive politike. Mirëpo, ato hynë në fuqi më 21 maj dhe prandaj nuk mund të zbatoheshin për këto zgjedhje.

¹⁵ Edhe pse shumica e dispozitave të Kodit Zgjedhor vlejné për të dy rrethet zgjedhore, ligji nuk thotë gjë për çështje të tilla si p.sh. akreditimin e vëzhguesve dhe të përfaqësuesve të kandidatëve, si dhe ndarjen e hapësirës për bilborde dhe pllakate ndërmjet kandidatëve të balotazhit. Ligji gjithashtu nuk është i qartë sa i përket kërkesave për financimin e fushatës në rrethin e dytë.

¹⁶ Këto përfshijnë udhëzime për emërimin dhe regjistrimin e kandidatëve, shpërndarjen e tabelave dhe bilbordeve reklamuese, për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore dhe për votimin në shtëpi.

¹⁷ Për shembull, kandidatit të mbështetur nga partitë në pushtet iu nda 40 për qind e hapësirës së përgjithshme komerciale në bilborde, ndërsa 40 për qind të tjera u ndanë ndërmjet dy kandidatëve të mbështetur nga partitë opozitare dhe 20 për qind të mbetura u ndanë ndërmjet tre kandidatëve sipas marrëveshjes së tyre të ndërsjellë.

¹⁸ Seksioni II.2.a i [Kodit të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore i vitit 2002](#) i Komisionit të Venedikut rekomandon që "përveç rregullave mbi çështjet teknike dhe detajet (të cilat mund të përfshihen në rregulloret e pushtetit ekzekutiv), rregullat e ligjit zgjedhor duhet të kenë të paktën gradën e statutit".

Zgjedhjet u administruan nga administrata me tre nivele, e përbërë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), dhe 3.396 Këshilla Zgjedhorë (KZ), duke përfshirë edhe rreth 32 zyra diplomatike dhe konsullore në 24 vende. Gjatë gjithë procesit zgjedhor, shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në profesionalizmin dhe paanshmërinë e përgjithshme të administratës zgjedhore në të gjitha nivelet.

KSHZ-ja është autoriteti më i lartë zgjedhor me kompetenca rregullatore, monitoruese dhe mbikëqyrëse, dhe është përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve dhe referendumeve. KSHZ-ja aktuale u krijua në korrik të vitit 2018 dhe përbëhet nga shtatë anëtarë (duke përfshirë tre gra) të emëruar nga partitë politike parlamentare.¹⁹ Mandati i KSHZ-së aktuale, i cili fillimisht ishte caktuar për gjashtë muaj për ta administruar referendumin e vitit 2018, në nëntor të vitit 2018 u vazhdua edhe për dy vite tjera. Për t'i kryer detyrat e saj, KSHZ-ja mbështetet nga 34 zyra rajonale dhe një sekretariat. Në kundërshtim me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, një numër i punonjësve kryesorë të sekretariatit, përfshirë edhe sektorin juridik, punuan në bazë të kontratave të përkohshme. Megjithëse për periudhën zgjedhore burimet e KSHZ-së u forcuan duke rekrutuar personel shtesë të përkohshëm, mungesa e kapacitetit në departamentin juridik dhe atë të TIK-ut, e dëmtuan efektivitetin e përgatitjeve.

Për të siguruar stabilitet dhe profesionalizëm të administratës zgjedhore, duhet të miratohen dispozita ligjore të cilat përcaktojnë qartë përbërjen dhe kohëzgjatjen e mandatit të një Komisioni të përhershëm Shtetëror Zgjedhor. Personeli thelbësor i sekretariatit të KSHZ-së duhet të punësohet në baza të përhershme.

Në përgjithësi, KSHZ-ja funksionoi kolegjisht dhe respektoi shumicën e afateve kohore ligjore, ndonëse u vonua me disa përgatitje.²⁰ Gjatë periudhës zgjedhore, komisioni mbajti mbledhje publike ku morën pjesë palë të ndryshme të interesuara, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e kandidatëve, vëzhguesit e akredituar dhe përfaqësuesit e mediave. Megjithatë, mbledhjet nuk u paralajmëruan në mënyrë të rregullt ose ftesat u dërguan pak kohë para mbajtjes së tyre. Në përputhje me mandatin e saj që të sigurojë zbatim uniform të ligjit, KSHZ-ja publikoi rregulla, edhe pse ndonjëherë relativisht vonë gjatë procesit zgjedhor dhe jo gjithmonë ofroi udhëzime të mjaftueshme.²¹

Vendimet e KSHZ-së përgjithësisht u miratuan unanimisht dhe në mënyrë të paanshme. Megjithatë, propozim-vendimet u diskutuan kryesisht nga KSHZ-ja në mbledhje të mbyllura, duke i kufizuar mbledhjet publike vetëm në votim formal, gjë që e zvogëloi transparencën. Për më tepër, disa procesverbale të mbledhjeve dhe vendimet e miratuara u publikuan me vonesë. Megjithëse mbledhjet u mbajtën kryesisht në gjuhën maqedonase, disa vendime të rëndësishme u publikuan edhe në gjuhën shqipe. Në disa mbledhje u ofrua interpretim në gjuhën e shenjave, gjë që e rriti disponueshmërinë e informacionit për publikun.

Për disa javë para rrethit të parë, sistemi kyç i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) i KSHZ-së nuk funksionoi si duhet, gjë që ndikoi në ofrimin në kohë të informacionit, duke përfshirë publikimin e procesverbaleve, udhëzimeve dhe vendimeve, kontrollimin onlajn të të dhënave të

¹⁹ Katër anëtarë u emëruan nga partitë në pushtet (tre nga LSDM-ja dhe një nga BDI-ja), duke përfshirë edhe nënkryetarin, ndërsa tre nga partitë opozitare (dy nga VMRO-DPMNE-ja dhe një nga BESA), duke përfshirë edhe kryetarin e KSHZ-së.

²⁰ Për shembull, shtypja e doracakëve për trajnime për komisionet e nivelit më të ulët, zgjedhja e zëvendësuesve për anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve që dhanë dorëheqje ose që nuk ishin në gjendje t'i kryejnë detyrat e tyre, si dhe kompensimi i shpenzimeve për fushatën mediatike. Më tej, vendimi për shumat e shpërblimit për disa punonjës të përkohshëm, si dhe për anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve u miratua pas zgjedhjeve.

²¹ Në udhëzimet e tilla bënin pjesë ato që kishin të bëjnë me plotësimin e protokolleve të rezultateve dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe me përmbledhjen e rezultateve preliminare duke e përdorur aplikacionin celular Viber. Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve në ditët e zgjedhjeve dëshmoi se ka interpretime të ndryshme të rregullave të KSHZ-së.

votuesve në regjistrin e votuesve, dhe regjistrimin onlajn të ankesave.²² Sipas KSHZ-së, këto dështime teknike nuk ndikuan në përgatitjet për rrethin e dytë.²³ Pavarësisht nga kjo, ky incident ngriti pyetje në lidhje me sigurinë e TIK-ut të KSHZ-së.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të hartojë udhëzime gjithëpërfshirëse për sigurinë kibernetike për gjithë personelin dhe sistemet që menaxhojnë ose përmbajnë të dhëna zgjedhore. Ai duhet të mbajë trajnime për të gjithë anëtarët dhe punonjësit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të Komisioneve Zgjedhore Komunale për zbutjen e rreziqeve dhe për trajtimin e incidenteve të mundshme të sigurisë kibernetike.

KZK-të, të cilat janë emëruar në vitin 2016, përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale me mandat pesëvjeçar. Megjithëse ligji kërkon që puna e administratës zgjedhore të jetë publike, niveli i transparencës së aktiviteteve të KZK-ve ndryshonte nëpër komuna. Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it u lejuan të merrnin pjesë në mbledhjet e KZK-ve, megjithatë, shumica e KZK-ve nuk i lajmëruan mbledhjet paraprakisht, e po ashtu nuk i publikuan procesverbalet e mbledhjeve e as ndonjë vendim.

Për të rritur transparencën dhe vetëdijen publike, Komisionet Zgjedhore Komunale duhet t'i publikojnë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve në kohë dhe në mënyrë konsekuente. Për këtë qëllim duhet të sigurohen mjete përkatëse, si për shembull qasje në ueb-faqet e komunave ose në platformat e tyre në rrjetet sociale.

KZ-të përbëhen nga tre anëtarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve shtetërorë me mandat katërvjeçar, si dhe nga dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga partitë parlamentare për çdo zgjedhje. Anëtarët e tanishëm jo-partiakë të KZ-ve u emëruan në vitin 2017. Shumica e KZK-ve e përfunduan formimin e KZ-ve sipas planit, megjithëse mungesa e qasjes dhe pasaktësia e bazës së të dhënave të anëtarëve të mundshëm të KZ-ve, që administrohet nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, e vonoi procesin në disa raste.²⁴ Në përgjithësi, organet zgjedhore të nivelit më të ulët punuan në mënyrë profesionale dhe efikase.

Sipas Kodit Zgjedhor, çdo gjini duhet të përfaqësohet me së paku 30 për qind të anëtarëve në organet e administratës zgjedhore, e gjithashtu duhet të përfaqësohen në mënyrë adekuate dhe të drejtë edhe të gjitha bashkësitë etnike që përbëjnë së paku 20 për qind të popullsisë në komunën përkatëse. Këto kritere kryesisht u respektuan, megjithatë KSHZ-ja nuk përpiloi të dhëna në nivel shtetëror për përbërjen gjinore dhe etnike të administratës zgjedhore në të gjitha nivelet.²⁵ Në rast të mungesës së punonjësve të përshtatshëm për t'u emëruar nga radhët e administratës publike, veçanërisht në mesin e grave nga

²² Sipas KSHZ-së, disa dështime të TIK-ut ishin rezultat i shkarkimit pa dashje të programit dëmtues (malware) nga një punonjës.

²³ Sipas KSHZ-së, pas zgjedhjeve do të bëhet një revizion i defekteve të sistemit të TIK-ut.

²⁴ Rreth dy javë para rrethit të parë, 90 KZ që u takojnë tetë KZK-ve nuk ishin kompletuar. Sipas KZK-së në komunën e Sarajit, në ditën e parë të zgjedhjeve, 15 KZ ende nuk ishin kompletuar, me ç'rast kryesisht mungonte një anëtar. Thuhet se këto KZ u kompletuan deri në ditën e zgjedhjeve të balotazhit. Afati i fundit për formimin e KZ-ve ishte 1 marsi, ndërsa për KZK-të ishte 21 shkurti.

²⁵ Nga 80 KZK, pesë nuk e kanë respektuar kërkesën për përfaqësim gjinor, ndërsa njëra për balancën etnike. Paragrafi 48d i Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 23 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), kërkon që palët shtetërore të japin "të dhëna statistikore, të ndara sipas gjinisë, që e tregojnë përqindjen e grave në krahasim me atë të burrave që i gëzojnë ato të drejta", ndërsa Paragrafi 17 i Rekomandimit të Përgjithshëm nr. 32 të Komisionit për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) këshillon që "vlerësimet e nevojës për masa speciale duhet të bëhen në bazë të të dhënave të sakta, të ndara sipas racës, ngjyrës, prejardhjes dhe origjinës etnike ose kombëtare". Shih po ashtu paragrafin 29 të [të vëzhgimeve përmblylëse të CEDAW-it të vitit 2018](#) dhe paragrafin 6 të [vëzhgimeve përmblylëse të CERD-it të vitit 2015](#).

bashkësitë pakicë, KSHZ-ja dhe KZK-ja duhet të zgjedhin anëtarë nga komunat e tjera. Përfaqësuesit e bashkësive më të vogla etnike në vend, përfshirë edhe romët, ndanë mendimet e tyre me MVZ-në e ODIHR-it se ata nuk ishin të përfaqësuar në mënyrë adekuate në organet zgjedhore, sikurse edhe në organet e tjera shtetërore.²⁶ Gratë ishin të përfaqësuar mirë në administratën zgjedhore (duke përbërë rreth dy të tretat e anëtarëve), mirëpo përfaqësuan vetëm një të tretën e kryetarëve të KZK-ve. Në radhët e KZ-ve të vëzhguar nga MVZ-ja e ODIHR-it në ditën e zgjedhjeve, rreth dy të tretat e anëtarëve dhe të kryetarëve ishin gra.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, të dhënat e zbërthyera për përfaqësimin gjinor dhe etnik që u përgatitën gjatë procesit zgjedhor duhet të publikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Para rrethit të parë, KZK-të mbajtën trajnime për të gjithë anëtarët e KZ-ve, duke përdorur video ku ishin përfshirë procedurat e ditës së zgjedhjeve. Kryetarët e KZ-ve dhe zëvendësit e tyre ndoqën trajnime shtesë, të organizuara në grupe më të vogla, nga trajnerë të certifikuar të KSHZ-së. Për këto trajnime interaktive, KSHZ-ja i përgatiti materialet për trajnim në pesë gjuhë dhe në mesin e trajnuesve kishte trajnues që flisnin në gjuhët e pakicave. Sipas KZK-ve, këto trajnime shtesë kontribuan në zvogëlimin e gabimeve gjatë ditëve të zgjedhjeve, dhe disa prej tyre e informuan MVZ-në e ODIHR-it se të gjithë anëtarët e KZ-ve kishin përfituar nga këto aktivitete trajnuese. Në të njëjtën kohë, shumicës së anëtarëve të KZ-ve nuk u ishin dorëzuar doracakët për trajnim deri një ditë para ditës së parë të zgjedhjeve dhe nuk u trajnuan të gjithë anëtarët e sapo zgjedhur të KZ-ve. Pas ankesave kundër rezultateve të disa vendotimeve pas rrethit të parë dhe të dytë (shih *Ankesat dhe apelimet dhe Zhvillimet pas zgjedhjeve*), për shkak të mangësive procedurale KSHZ-ja vendosi të bëjë shkarkime në 13 dhe 6 KZ, respektivisht.²⁷

Fushata për edukimin e votuesve që u zhvillua nga KSHZ-ja gjatë periudhës së zgjedhjeve ishte modeste, kryesisht duke i shfrytëzuar mediat transmetuese dhe rrjetet sociale, dhe filloi relativisht vonë në periudhën parazgjedhore.²⁸ KSHZ-ja informoi MVZ-në e ODIHR-it se përmasat e fushatës së edukimit të votuesve ishin të kufizuara për shkak të buxhetit të kufizuar. Është pozitive se videot për edukimin e votuesve ishin në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të shoqëruara me interpretim në gjuhën e shenjave, dhe me titra për bashkësitë e tjera etnike. Materialet për edukimin e votuesve përmbanin informata për të drejtat e votuesve, procedurat e votimit, dhe shkeljet zgjedhore. Mirëpo, edukimi i votuesve nuk mundësoi informacione në kohë dhe të detajuara në lidhje me ndalimin e votimit në grup dhe të votimit familjar, si dhe për procedurat për parashtrim të ankesave për votuesit në ditën e zgjedhjeve. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se nuk ka pasur informata të mjaftueshme gjatë periudhës së këqyrjes publike të listave të votuesve sa i përket përjashtimit të votuesve për shkak të skadimit të afatit të vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit (shih *Regjistrimi i votuesve*).

²⁶ Në paragrafin 24 të [vëzhgimeve përmbyllëse të CERD-it të vitit 2015](#) vihet në dukje se "që nga viti 2001, përfaqësimi i bashkësive më të vogla etnike në administratën publike është rritur. Përkundër këtij përparimi të dukshëm, Komisioni beson se nevojiten përpjekje shtesë për sa i përket qasjes në pozicionet drejtuese dhe menaxheriale për anëtarët e bashkësive që nuk janë shumicë, veçanërisht për ata që i përkasin bashkësive më të vogla etnike". Shih edhe paragrafin 29.b të [vëzhgimeve përmbyllëse të CEDAW-it të vitit 2018](#), i cili vuri në dukje "mungesë programesh dhe strategjish për të siguruar pjesëmarrjen e grave rome, grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës dhe në pozicionet dhe proceset vendimmarrëse në organizatat publike dhe private".

²⁷ Gjithsej, 79 anëtarë të KZ-ve u shkarkuan pas rrethit të parë. Aty ku mund të përcaktohej përgjegjësia individuale, u shkarkuan vetëm anëtarët përgjegjës të KZ-ve, përndryshe zëvendësohej e gjithë KZ-ja.

²⁸ Fushata mediatike u plotësua me turne të një minibusi informativ anembanë vendit. KSHZ-ja po ashtu hapi linjë telefonike falas për pyetjet e votuesve. Një linjë e specializuar telefonike me video ishte në dispozicion për votuesit me dëgjim të dëmtuar. Sipas KSHZ-së, linja telefonike u shfrytëzua nga 89 votues.

Për të rritur ushtrimin efektiv të të drejtës së votës, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një program gjithëpërfshirës dhe në kohë që synon edukimin e votuesve, duke përfshirë informata për regjistrimin e votuesve, votimin familjar dhe procedurat për ankesë.

Votimi i hershëm u administrua për votuesit në shtëpi, personat e zhvendosur në brendi të vendit dhe votuesit në institucionet ndëshkuese më 20 prill dhe 4 maj.²⁹ Pozitivisht, si projekt pilot, votimi i hershëm po ashtu u mundësua në një shtëpi pleqsh dhe në një spital special në Shkup. Gjithsej 6.621 votues hodhën fletëvotime gjatë votimit të hershëm në vend në rrethin e parë.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, personat me aftësi të kufizuara të cilëve u është marrë e drejta e votimit me vendim gjyqësor, janë të privuar nga votimi.³⁰

Siç është rekomanduar më parë, legjislacioni duhet të harmonizohet me qëllimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke i hequr të gjitha kufizimet e të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale.

Sistemi i regjistrimit për votimin në vend është pasiv dhe i vazhdueshëm, dhe bazohet në informatat e nxjerra nga regjistrat civilë dhe regjistrat e tjerë kombëtarë.³¹ Qytetarët që janë regjistruar se banojnë përkohësisht jashtë vendit u përfshinë në lista të veçanta të votuesve brenda vendit. Ata gjithashtu mund të regjistroheshin në mënyrë aktive për të votuar jashtë vendit, në vendvotimet në zyrat diplomatike dhe konsullore.³² Edhe pse KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve, ajo nuk ka kapacitet të administrojë përpunimin organizativ, teknik dhe metodologjik të të dhënave, të cilën e bën Enti Shtetëror Statistikor.

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë t'i kontrollojnë të dhënat e tyre individuale në regjistrin e votuesve, personalisht ose onlajn, dhe të kërkojnë ndryshime gjatë gjithë vitit. Këqyrja publike e listës së votuesve për këto zgjedhje u bë midis 23 shkurtit dhe 14 marsit, kur votuesit kishin mundësi t'i kontrollojnë të

²⁹ Një mundësi për të votuar më herët ishte në dispozicion edhe më 17 prill dhe 1 maj në KSHZ, për anëtarët e KZ-ve që e administruan votimin jashtë vendit.

³⁰ Shih nenet 12 dhe 29 të KDPAK-së të vitit 2006. Shih gjithashtu paragrafin 9.4 të Komunikatës Nr. 4/2011 të Komisionit të KDPAK-së të vitit 2013, ku thuhet se “Neni 29 nuk parasheh asnjë kufizim të arsyeshëm, e as që lejon ndonjë përjashtim për cilindo grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paafësisë së perceptuar ose aktuale psiko-sociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në kuptim të nenit 2 të Konventës”.

³¹ Ministria e Punëve të Brendshme katër herë në vit i ofron KSHZ-së informata për qytetarët që e kanë arritur moshën e pjekurisë dhe për lëshimin e dokumenteve të identifikimit në bazë të regjistrave të shtetësisë dhe të vendbanimit. Gjykatat themelore e informojnë KSHZ-në për qytetarët e privuar nga e drejta ligjore për të votuar dhe ata që gjenden në paraburgim. Çdo muaj Ministria e Drejtësisë ofron informata për personat e vdekur. Ministria gjithashtu përpilon një listë të veçantë të votuesve me personat e zhvendosur në brendi të vendit. Jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve, organi përgjegjës për administrimin e sanksioneve i dërgon të dhëna KSHZ-së për personat që janë në paraburgim ose që vuajnë dënim me burg.

³² Për të hapur një vendvotim nevojiten të paktën 10 votues të regjistruar. Tridhjetë e katër vendvotime u hapën në zyrat diplomatike dhe konsullore jashtë vendit, ku 832 votues i hodhën votat e tyre në rrethin e parë, dhe 827 gjatë balotazhit.

dhënat e tyre dhe të kërkojnë ndryshime ose korrigjime personalisht në zyrat rajonale të KSHZ-së.^{33 34} Sipas KSHZ-së, 53.972 votues e shfrytëzuan këtë mundësi, duke i përfshirë edhe votuesit që erdhën për t'u nënshkruar në listat për emërimin e kandidatëve. KSHZ-ja siguroi kopje të listave paraprake të votuesve për pesë parti parlamentare pas përfundimit të këqyrjes publike. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësim për keqpërdorimin e të dhënave personale të votuesve nga partitë politike për t'i ndjekur dhe për t'u bërë presion votuesve.

Regjistri i votuesve u mbyll më 29 mars, rreth tre javë para ditës së zgjedhjeve. Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it ishin të mendimit se mbyllja e regjistrimit të votuesve shumë kohë përpara ditës së zgjedhjeve, së bashku me periudhën relativisht të shkurtër të këqyrjes publike, nuk u ofroi votuesve mundësi të mjaftueshme për ta informuar KSHZ-në për ndryshimet e kohës së fundit në të dhënat e tyre. Regjistri përfundimtar përfshinte 1.808.131 votues, nga të cilët 77.579 ishin përfshirë në listat speciale të votuesve që përkohësisht banojnë jashtë vendit.³⁵ Ligji nuk parashikon përditësim të regjistrimit të votuesve ndërmjet dy rretheve për t'i pasqyruar ndryshimet në të dhënat në regjistrat civilë.³⁶

Për të përmirësuar saktësinë e listave të votuesve dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e votuesve, duhet konsideruar mundësia për zgjatjen e periudhës së këqyrjes publike të listave të votuesve dhe për vendosje të afatit të fundit për të bërë ndryshime më afër ditës së zgjedhjeve. Po ashtu mund të konsiderohet mundësia për përditësim të regjistrimit të votuesve ndërmjet rretheve zgjedhore.

Qytetarët janë të përfshirë në regjistrin e votuesve nëse janë banorë të regjistruar në vend dhe nëse posedojnë letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë. Votuesit, të cilëve u kishte skaduar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim para ditës së zgjedhjeve, u hoqën automatikisht nga listat e votuesve, përveç nëse i kishin përtërirë dokumentet e tyre dhe e kishin njoftuar zyrën rajonale të KSHZ-së për këtë ndryshim përpara përfundimit të periudhës së këqyrjes publike më 14 mars. Prandaj, një numër i konsiderueshëm i votuesve me të drejtë vote që i përtërinë dokumentet e tyre të skaduara, por nuk i njoftuan autoritetet për këtë, u privuan nga e drejta e votës, që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.³⁷ Në ditët e zgjedhjeve, MVZ-ja e ODIHR-it vërejti votues me dokumente të vlefshme të identifikimit që u kthyen prapa sepse nuk ishin të përfshirë në listat e votuesve.³⁸

Votuesit me të drejtë vote nuk duhet të përjashtohen nga regjistri i votuesve për shkak të dokumenteve të skaduar. Duhet të ndërmerren masa legjislative dhe administrative për t'i mundësuar secilit që ka të drejtë të votojë të ushtrojë këtë të drejtë në mënyrë efektive.

Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it i potencuan përmirësimet në saktësinë e regjistrimit të votuesve, duke i përmendur përpjekjet e ndryshme të KSHZ-së, siç është revizioni i gjerë i ndërmarrë

³³ Bashkëbiseduesit e informuan MVZ-në e ODIHR-it se lista e shtypur e votuesve nuk ishte nxjerrë në disa zyra, duke përfshirë Kumanovën, Gjevgjelinë, Prilepin, Strumicën dhe Shtipin.

³⁴ Si rezultat i kësaj, 517 votues u shtuan në listat e votuesve, 412 u përjashtuan, ndërsa të dhënat e 129 votuesve u korrigjuan.

³⁵ Listat speciale gjithashtu përfshinin 1.640 votues në burgje, 71 votues në institucionet për të moshuarit, 7 persona të zhvendosur në brendi të vendit dhe 357 anëtarë të këshillave zgjedhore jashtë vendit.

³⁶ Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, 1.145 qytetarë i mbushën 18 vjet midis 22 prillit dhe 5 majit.

³⁷ Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) i obligon vendet pjesëmarrëse të "garantojnë votim universal dhe të barabartë për qytetarët moshë rritur". Paragrafi 11 i Komentit të përgjithshëm nr. 25 të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB-ve (KDPC) të vitit 1996, kërkon që shtetet "të marrin masa efektive për të siguruar se të gjithë personat me të drejtë vote të mund ta ushtrojnë këtë të drejtë". Në rastet kur kërkohet regjistrimi i votuesve, kjo duhet të lehtësohet dhe nuk duhet të vendosen pengesa për regjistrimin e tillë."

³⁸ Që nga 1 marsi, votuesit kishin mundësi t'i rinovojnë ose t'i zëvendësojnë letërnjoftimet e tyre me procedurë të përshpejtuar. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga 47.903 qytetarë, dokumentet e të cilëve kishin skaduar midis 8 shkurtit dhe 21 prillit, 38.166 morën letërnjoftime të përtërirë deri më 14 mars dhe 6.226 votues të tjerë i përtërinë dokumentet e tyre midis 15 marsit dhe 21 prillit. Megjithatë, vetëm 517 votues u futën përsëri në regjistrin e votuesve gjatë periudhës së këqyrjes publike.

në vitin 2016.³⁹ Megjithëse rezultatet e revizionit më pas u anuluan, palët e interesuara shprehën besim të përgjithshëm sa i përket regjistrin të votuesve, përkundër përfshirjes së vazhdueshme të votuesve të vdekur dhe mospërputhjeve në të dhënat e adresës. Në të njëjtën kohë, mangësitë strukturore e vështirësojnë mirëmbajtjen e regjistrin të votuesve. Mospërputhjet midis të dhënave individuale në regjistrat e ndryshëm shtetërorë dhe formatet e tyre të ndryshme të të dhënave e pengojnë shkëmbimin efektiv të të dhënave midis institucioneve shtetërore, përkundër disa përpjekjeve fillestare për t'i harmonizuar të dhënat.⁴⁰ Për më tepër, cilësia e dobët e të dhënave të adresës çon në vështirësi dhe gabime gjatë caktimit të votuesve në vendvotime.⁴¹

Autoritetet shtetërore duhet të vazhdojnë me përpjekje të koordinuara dhe sipas përgjegjësive të përcaktuara qartë, të bëjnë përditësimin dhe harmonizimin e të gjithë regjistrave dhe bazave përkatëse të të dhënave për të siguruar një bazë të saktë për regjistrin e votuesve.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Sipas Kushtetutës, një shtetas që ka mbushur së paku 40 vjet, i cili ka banuar në vend së paku 10 vjet nga 15 vitet e fundit, ka të drejtë të kandidojë për postin e kryetarit të vendit. Kriteri i dytë bie ndesh me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet ndërkombëtare.⁴²

Autoritetet duhet ta rishqyrtojnë kriterin për banim në vend për kandidatët presidencialë.

Emërimi i një kandidati presidencial duhet të mbështetet me nënshkrime të 30 deputetëve ose të paktën prej 10.000 votuesve. Siç kërkohet me ligj, votuesit nënshkruan mbështetjen e tyre për kandidatët e emëruar në hapësirat e zyrave rajonale të KSHZ-së, gjë që mundësoi verifikim të drejtpërdrejtë të origjinalitetit të nënshkrimeve. Për të lehtësuar procesin, KSHZ-ja hapi 45 zyra të përkohshme, krahas 34 zyrave të përhershme rajonale. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në praktikën e mbledhjes së nënshkrimeve në zyrat rajonale të KSHZ-së, megjithëse dy kundërshtime u parashtruan në KSHZ.⁴³

³⁹ Para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, KSHZ-ja bëri kontrollim të kryqëzuar të bazës kryesore të të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme me ato të institucioneve të tjera shtetërore dhe bëri kontrole të gjera në terren. KSHZ-ja identifikoi 330.549 shënime jokonzistente të të dhënave, duke përfshirë edhe rreth 171.500 qytetarë për të cilët konsiderohej se banonin përkohësisht jashtë vendit. Rreth 28.000 votues u hoqën nga regjistri i votuesve. Ky revizion i regjistrin të votuesve u zbatua vetëm për zgjedhjet e vitit 2016.

⁴⁰ Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë ka përpiluar plane për krijimin e një regjistri të përhershëm kombëtar të popullsisë, i cili do të përfshinte standardizim të kodeve, emërtimit dhe numërimit të rrugëve në regjistrat e ndryshëm institucionalë. Megjithëse një projekt pilot për t'i përditësuar regjistrat e truallit është realizuar në katër komuna, MVZ-ja e ODIHR-it nuk u informua për ndonjë afat kohor për përfundimin e regjistrin të ri kombëtar.

⁴¹ Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, problemet kryesisht paraqiten për shkak të emrave të pasaktë, jo konsekuente dhe të vjetruar të rrugëve, si dhe për shkak të adresave jo-ekzistuese dhe numrave jo-ekzistues të shtëpive. Pasi që kërkesa për ta deklaruar ndryshimin e adresës nuk zbatohet gjithmonë, shumë qytetarë mund të regjistrohen në adresën e njëjtë. Qytetarët që banojnë përkohësisht jashtë vendit janë të përfshirë në regjistrin e votuesve në bazë të vendbanimit të tyre të fundit në vend.

⁴² Paragrafi 15 i Komentit të përgjithshëm të KDPC-së nr. 25 thotë se "personat që përndryshe kanë të drejtë të kandidojnë për t'u zgjedhur nuk duhet të përjashtohen me anë të kërkesave të paarsyeshme ose diskriminuese siç janë arsimimi, vendbanimi ose prejardhja, ose për shkak të përkatësisë politike". Shih gjithashtu Paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së dhe seksionet I.1.1.c.iii-v të Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut të vitit 2002 (Kodi i praktikës së mirë).

⁴³ Dy kandidatë të pasuksesshëm pretenduan se kanë pasur pengesa për mbledhjen e nënshkrimeve, duke përfshirë edhe orë të parregullta të punës të zyrave rajonale të KSHZ-së; të dy kundërshtimet u refuzuan si të papranueshme.

Kodi Zgjedhor përcakton një periudhë dy-javore për mbledhjen e nënshkrimeve, e cila u realizua midis 23 shkurtit dhe 9 marsit. Siç është rekomanduar më parë nga ODIHR-i, votuesit me nënshkrimin e tyre mund të mbështesin më shumë kandidatë. Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të nënshkrimeve që kërkohen të mblidhen, ky afat kohor është relativisht i shkurtër dhe ka mundësi ta kufizojë inkluzivitetin e procesit të emërimit të kandidatëve.

Nga nëntë kandidatët potencialë të cilët shpallën qëllimin e tyre për të mbledhur nënshkrime për mbështetje nga votuesit, tre arritën të mbledhin numrin e nevojshëm të nënshkrimeve. KSHZ-ja i pranoi dhe i shqyrtoi dokumentet për emërim brenda afatit ligjor, dhe tre kandidatë u regjistruan më 21 mars, duke përfshirë një grua dhe një kandidat shqiptar etnik. Sipas KSHZ-së, z. Pendarovski u mbështet me 31.729 nënshkrime të votuesve, z. Reka me 11.128, dhe znj. Siljanovska Davkova me 15.926. Edhe pse u regjistruan si kandidatë jo-partiakë, secili nga tre kandidatët u mbështet nga parti politike para mbledhjes së nënshkrimeve dhe regjistrimit, dhe përdorën simbole partiake për identifikim në fletëvotim.⁴⁴ Shumica e bashkëbiseduesve nuk ngritën shqetësime për inkluzivitetin e përgjithshëm të procesit.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata u zhvillua në ambient të qetë dhe paqësor. Liritë themelore për tubim dhe shprehje u respektuan, dhe pjesëmarrësit në zgjedhje ishin në gjendje të zhvillojnë fushatë lirshëm dhe pa pengesa. Periudha zyrtare e fushatës filloi më 1 prill, 20 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kishte një periudhë të heshtjes zgjedhore që filloi 24 orë para çdo dite të zgjedhjeve dhe zgjati deri në mbylljen e vendvotimeve. Kodi Zgjedhor parashikon sanksion për personat juridikë që do të zhvillojnë fushatë jashtë periudhës së fushatës. Rregullat çuan në një situatë anormale në të cilën kandidatët e mundshëm zhvilluan fushatë deri në regjistrimin e tyre zyrtar, dhe më pas e ndërprejnë fushatën deri në fillimin e periudhës së fushatës. Ndërkohë, partitë politike i vazhduan aktivitetet e tyre, duke përfshirë edhe përkrahjen e kandidatëve presidencialë pas të cilëve qëndronin.⁴⁵

Duhet konsideruar mundësia e përshtatjes së periudhës zyrtare të fushatës me periudhën kohore për regjistrimin e garuesve, për të siguruar se rregullat e fushatës vlejné në mënyrë konsekuente për të gjithë pjesëmarrësit. Aktivitetet e rregullta politike para periudhës zyrtare të fushatës nuk duhet të jenë të jashtëligjshme.

Para rrethit të parë, kandidatët zhvilluan fushatë të gjerë në gjithë vendin duke përdorur mjete të llojllojshme tradicionale, si dhe platformat e mediave sociale. Ata mbajtën takime të vogla për t'u takuar me votuesit si dhe tubime më të mëdha së bashku me kryetarët e partive, të cilët kishin prezencë të spikatur në fushatë. Edhe pse dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me ndarjen e bilbordeve komerciale ishin të paqarta (shih *Korniza ligjore*), në praktikë bilbordet komerciale u shfrytëzuan gjerësisht, dhe vendosja e tyre nuk u tregua kontestuese. Aktivistët lokalë zhvilluan fushatë derë më derë dhe shpërndanë fletëpalosje. Zhvillimi i fushatës para balotazhit ishte më e qetë, pasi periudha e shkurtër e fushatës u përputh me festën ortodokse të Pashkëve dhe Ditën e Punës, dhe të dy kandidatët e mbetur iu shmangën tubimeve të mëdha të fushatës në favor të ngjarjeve më të vogla dhe shfrytëzimit të gjerë të reklamave të paguara në media. Marrëveshja e Prespës dhe integrimet euro-atlantike ishin çështje të rëndësishme në të dyja rrethet e fushatës, sikurse edhe emigracioni, korrupsioni dhe sundimi i ligjit.

⁴⁴ Z. Pendarovski përdori simbolin e LSDM-së, z. Reka i përdori simbolet e Aleancës së Shqiptarëve dhe të BESË-s së bashku me simbolin e tij, ndërsa znj. Siljanovska Davkova përdori simbolin e VMRO-DPMNE-së.

⁴⁵ KSHZ-ja i hodhi poshtë tre ankesa në të cilat pretendohesh se znj. Siljanovska Davkova dhe z. Pendarovski kanë zhvilluar fushatë para kohe.

Edhe pse të gjithë kandidatët ishin formalisht të pavarur, z. Pendarovski dhe, në veçanti, znj. Siljanovska Davkova u varën shumë nga mbështetja organizative e partive. Megjithëse kandidatët në përgjithësi iu shmangën gjuhës së ashpër, pati raste të retorikës nxitëse nga përfaqësuesit e partive, si në mediat tradicionale ashtu edhe në ato sociale.⁴⁶ Në ditët e fundit të fushatës së rrethit të parë, u paraqitën polemika publike mbi pretendimet e opozitës se një aplikacion celular i LSDM-së për qëllime të fushatës, ka keqpërdorur të dhënat personale, gjë që u mohua nga LSDM-ja. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kreu një hetim të aplikacionit dhe e informoi MVZ-në e ODIHR-it se edhe pse kishte disa parregullsi të vogla, nuk kishte dëshmi për keqpërdorim të të dhënave personale. Në fushatën e rrethit të dytë, të dyja palët përdorën mesazhe gjithnjë e më negative të fushatës, me akuza të ndërsjella për keqpërdorim të pushtetit gjatë qeverisjes.

Kodi Zgjedhor përmban dispozita të hollësishtme për mbështetjen e ndarjes së shtetit dhe partisë, ndalimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore dhe sigurimin e përdorimit të barabartë të hapësirave publike.⁴⁷ Në pjesën më të madhe, funksionarët shtetërorë u duk se e ruajtën dallimin ndërmjet detyrave të tyre zyrtare dhe aktiviteteve politike, duke mos përdorur burime shtetërore ose duke mos u përfshirë në aktivitete të fushatës gjatë orarit të punës.⁴⁸ Pavarësisht nga kjo, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi disa pretendime se punonjësve të sektorit publik u ishin bërë presione për të marrë ose për të mos marrë pjesë në aktivitete të fushatës, veçanërisht në jug-perëndim të vendit. Asnjë pretendim konkret nuk u konfirmua. Siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, kandidatët e nënshkruan kodin e sjelljes së mirë duke përfshirë edhe premtimin për të mos ushtruar presion mbi punonjësit e sektorit publik. Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë prezantoi një mjet nëpërmjet të cilit punonjësit publikë mund të denonconin çdo rast të presionit mbi ta, mirëpo nuk u parashtrua asnjë denoncim i tillë.⁴⁹ Zyra e Avokatit të Popullit pranoi disa denoncime për presion ndaj njerëzve për të mos votuar. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, politizimi i emërimeve në sektorin publik krijon një pikëpamje të përhapur gjerësisht se punonjësit duhet t'i mbështesin partitë në pushtet, madje edhe në mungesë të udhëzimeve të qarta për këtë.

Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme energjike për t'iu kundërvënë çdo formë të presionit ndaj punonjësve të sektorit publik, duke përfshirë edhe deklaratat e qarta publike dhe udhëzimet me shkrim nga funksionarët e lartë të shtetit se një presion i tillë nuk do të tolerohet dhe se asnjë qytetar nuk duhet të ketë frikë nga pasojat negative si rezultat i mbështetjes ose mos mbështetjes së ndonjë kandidati apo partie. Punonjësit e sektorit publik duhet të inkurajohen në mënyrë aktive që ta denoncojnë çdo rast presioni, dhe rastet e tilla duhet të hetohen plotësisht dhe të ndiqen penalisht, duke i mbrojtur ata që i denoncojnë këto raste.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ka mandat të reagojë ndaj keqpërdorimeve të mundshme të burimeve shtetërore, duke përfshirë edhe gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, KSHPK-ja kishte mungesë të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për ta monitoruar në mënyrë efektive respektimin e rregullave zgjedhore. KSHPK-ja publikoi një bazë të

⁴⁶ Duke përfshirë edhe kundër z. Reka në ngjarjet e fushatës të partive kryesisht të shqiptarëve etnikë që janë pjesë e koalicionit qeverisës, si dhe kundër z. Pendarovski në përmbajtjet tradicionale dhe në internet.

⁴⁷ Ndalohet përdorimi i zyrave shtetërore, pajisjeve ose i punonjësve për qëllime të fushatës. Nga pjesëmarrësit në zgjedhje kërkohet që t'i njoftojnë autoritetet së paku 48 orë përpara mbajtjes së një aktiviteti të fushatës në vend publik. Disa objekte nuk mund të përdoren për aktivitete të fushatës, duke përfshirë objektet fetare, spitalet, shkollat, shtëpitë e pleqve dhe institucionet e tjera publike, përveç nëse nuk ka ndonjë vend tjetër të përshtatshëm që është në dispozicion.

⁴⁸ Ndërmjet dy rretheve zgjedhore, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi një denoncim për pjesëmarrjen e një funksionari shtetëror në ngjarje të fushatës gjatë orarit të punës në Shkup. Për më tepër, një kundërshtim për përdorimin e një zyre të komunës në Shuto Orizare për një konferencë për shtyp në mbështetje të z. Pendarovski u pranua nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

⁴⁹ Ministria e informoi MVZ-në e ODIHR-it se nëntë denoncime ishin parashtruar duke e përdorur këtë mjet, por asnjë prej tyre nuk kishte të bëjë me presionin mbi funksionarët publik në lidhje me zgjedhjet.

dhënash të automjeteve që u përkisnin institucioneve shtetërore dhe u mbështet në organizatat e shoqërisë civile për të denoncuar nëse këto automjete ishin përdorur për zhvillim të fushatës; u parashtrua vetëm një denoncim i tillë. Kodi Zgjedhor e ndalon fillimin e projekteve të infrastrukturës me financim publik gjatë periudhës zgjedhore, si dhe, përveç në raste urgjente, punësimin e punonjësve të rinj publikë. Disa ankesa që pretendonin shkelje të këtyre rregullave u parashtruan në KSHPK (shih *Ankesa dhe Apelime*).⁵⁰

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit duhet të pajiset me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ta realizuar në mënyrë efektive mandatin e tij gjatë periudhës zgjedhore.

Vendi përbëhet nga disa bashkësi etnike.⁵¹ Një tipar i rëndësishëm i fushatës zgjedhore ishte se kandidatura e z. Pendarovskit mori mbështetje jo vetëm nga LSDM-ja, por edhe nga partitë që kryesisht i përfaqësojnë qytetarët me përkatësi etnike shqiptare dhe grupet e tjera etnike. Në fjalimet e tij të fushatës, z. Pendarovski e potencoi përkushtimin e tij për një shoqëri multi-etnike dhe rëndësinë e kohezionit ndëretnik, dhe politikanë të shquar me përkatësi etnike shqiptare folën në disa ngjarje të fushatës. Z. Reka e zhvilloi fushatën në të dy gjuhët, maqedonase dhe shqipe, megjithëse fushata e tij u përqendrua te votuesit shqiptarë etnikë. Partitë që e mbështetën Z. Reka kërkuan nga shqiptarët etnikë që të votojnë për të për ta demonstruar numrin e tyre të popullsisë. Në rrethin e dytë, fushata e znj. Siljanovska Davkova publikoi reklama edhe në gjuhën shqipe.

Disa parti i përfaqësojnë pakicat më të vogla etnike, shumica e të cilave janë në aleancë ose me LSDM-në ose me VMRO-DPMNE-në. Përfaqësuesit e këtyre partive morën pjesë aktive në fushatë, veçanërisht në vendet ku janë të përqendruara bashkësitë e tyre. Bashkëbiseduesit nga komuniteti rom e informuan MVZ-në e ODIHR-it se edhe pse mbetet shumë për t'u bërë për t'u trajtuar nevojat e romëve, abuzimet, si për shembull rastet e presionit dhe të blerjes së votave, janë zvogëluar. Pozitivisht, OJQ-ja *Avaja* organizoi një ngjarje të fushatës para rrethit të dytë, në të cilën morën pjesë të dy kandidatët presidencialë dhe u promovua pjesëmarrja e votuesve romë.

Gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike.⁵² Vetëm 4 nga 26 ministra qeveritarë janë gra, dhe vetëm 6 nga 81 kryetarë të komunave janë gra. Edhe pse një kandidate ishte grua, gratë nuk u paraqitën aq shpesh si folëse të fushatës dhe pjesëmarrja e grave në ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it ishte e ulët në mënyrë joproporcionale. Në fushatën e saj, znj. Siljanovska Davkova shpesh i trajtoi çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, duke premtuar se nëse zgjidhet do të punojë për ta promovuar pjesëmarrjen e grave në kabinetin e saj dhe në jetën publike. Z. Pendarovski po ashtu u zotua se do ta avancojë pjesëmarrjen e grave në politikë.

Gjatë fushatës u bënë disa përpjekje për t'i trajtuar shqetësimet e njerëzve me aftësi të kufizuara, me ç'rast kandidatët kohë pas kohe bënë thirrje për masa të shtuara për ta përmirësuar situatën e tyre në shoqëri. Pozitivisht, në disa ngjarje të mëdha të fushatës u siguroa interpretim në gjuhën e shenjave.

⁵⁰ Nga 16 ankesa të parashtruara në KSHPK për këtë çështje, vetëm dy u pranuan pjesërisht, ku KSHPK-ja konkludoi se informatat për iniciativat nuk duhej të ishin publikuar në media gjatë periudhës parazgjedhore. Dy raste u hapën nga KSHPK-ja sipas detyrës zyrtare.

⁵¹ Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002, 64.2 për qind e popullsisë u deklaruan si maqedonas etnikë, 25.2 për qind si shqiptarë etnikë, 3.8 për qind si turq etnikë, 2.7 për qind si romë etnikë, 1.8 për qind si serbë etnikë, 0.8 për qind si boshnjakë etnikë, 0.5 për qind si vllleh etnikë dhe 1 për qind si të tjerë. Në mungesë të të dhënave të fundit të regjistrimit, përbërja aktuale etnike e vendit është e paqartë.

⁵² Në paragrafin 29 të [vëzhgimeve përmbyllëse të CEDAW-it të vitit 2018](#) shprehet shqetësim se gratë mbeten "të papërfaqësuara në mënyrë adekuate në Kuvend, në Kabinet dhe në këshillat komunalë, në mesin e kryetarëve të komunave, në pozitat vendimmarrëse në shërbimin diplomatik dhe në gjyqësi"; dhe për "mungesën e programeve dhe strategjive për të siguruar pjesëmarrjen e grave rome, grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës dhe në pozicionet dhe proceset vendimmarrëse në organizatat publike dhe private".

Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it theksuan se në vitet e fundit ka përparim në përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara, për shembull në sigurimin e hyrjes në ndërtesat publike, duke përfshirë edhe ndërtesën e Kuvendit. Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara kryesisht nuk kanë qasje të barabartë në infrastrukturat fizike dhe ato të komunikimit, dhe aktualisht nuk ka asnjë deputet që është deklaruar se ka aftësi të kufizuara.⁵³

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës është i rregulluar me Kodin Zgjedhor të vitit 2006, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004 dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave të vitit 2018.⁵⁴ Disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës mbeten të patrajuara, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me shqyrtimin e detajuar të raporteve të përkohshme, afatin e fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare dhe diapazonin e revizionit të tyre.⁵⁵ Korniza ligjore i përcakton kriteret e përgjithshme për zbulimin e shpenzimeve dhe raportimin për financimin e fushatës, por rregullat nuk janë të qarta sa i përket shpeshtësisë së raportimit dhe sanksioneve për mosdorëzimin e raporteve të përkohshme, dhe nuk trajtojnë zhvillimin e fushatës nga palët e treta dhe raportimin e kredive.

Partitë kanë të drejtë për mjete publike nëse kanë fituar së paku një për qind të votave në zgjedhjet paraprake parlamentare ose lokale.⁵⁶ Kandidatët presidencialë nuk marrin drejtpërdrejtë mjete publike për fushatën, por pas ndryshimeve të vitit 2018 në Kodin Zgjedhor, reklamën politike në media kompensohen nga buxheti i shtetit. Kodi Zgjedhor përcakton një kufi të shpenzimeve prej 110 denarë për votues të regjistruar (që kap vlerën prej rreth 198 milionë denarë ose 3.2 milionë euro), i cili, sipas institucioneve përkatëse, vlen për të dyja rrethet zgjedhore së bashku. Kandidatët dhe partitë politike e informuan MVZ-në e ODIHR-it për një marrëveshje joformale ndërpartiake për të kufizuar edhe më shumë shpenzimet për reklamim në media, për të zvogëluar shumën e përgjithshme për kompensime nga buxheti i shtetit.

Garuesit në zgjedhje ishin të obliguar të regjistrojnë numra unikë tatimorë dhe hapën llogari të veçanta bankare përmes të cilave duhej të kryhen të gjitha transaksionet financiare që lidhen me fushatën. Fushatat financohen nga pagesat e anëtarësisë në parti dhe nga donacionet private. Donacionet publike, të huaja dhe ato anonime, midis burimeve të tjera, janë të ndaluara. Donacionet ishin të kufizuara në 3.000 euro për individë dhe 30.000 euro për persona juridikë, duke i përfshirë kontributet në natyrë.⁵⁷ Megjithëse partitë politike zhvilluan fushatë aktive për kandidatët që i mbështetën, nuk ka rregulla të qarta për zhvillimin e fushatës nga palët e treta dhe nuk ka kriteret për llogaridhënie për shpenzimet e

⁵³ Shih paragrafin 18 të [vëzhgimeve përmblyëse të KDPAK-së të vitit 2018](#), i cili rekomandoi "zbatimin e detyrueshëm të standardeve të qasjes në të gjitha fushat, veçanërisht sa i përket ndërtesave, transportit, objekteve dhe shërbimeve të tjera të hapura për publikun, dhe teknologjive dhe sistemeve të informacionit dhe të komunikimit".

⁵⁴ Ligji i jep kompetencë KSHPK-së të fillojë procedura në rast dyshimi për shkelje të rregullave të financimit të fushatës qoftë sipas detyrës zyrtare, në bazë të ankesës nga një organizator i fushatës ose nga një vëzhgues.

⁵⁵ Shih [Raportin e dytë për harmonizim nga rrethi i tretë i vlerësimit të GRECO-s të vitit 2014](#), dhe [Mendimin e përbashkët për Kodin Zgjedhor të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2016](#), si dhe [Rekomandimin Rec\(2003\)4](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

⁵⁶ Sipas ndryshimeve të Ligjit për Financimin e Partive Politike të vitit 2018, shumën e mjeteve publike për partitë politike u rrit nga 0.06 në 0.15 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit të shtetit.

⁵⁷ Vlera e paraqitur e të hyrave që i pranuan garuesit ishte rreth 20 milionë denarë për z. Pendarovski, rreth 16 milionë denarë për znj. Siljanovska Davkova, dhe rreth 1 milionë denarë për z. Reka. Zn. Siljanovska Davkova e financoi fushatën e saj kryesisht me donacione nga individët, z. Reka me donacione nga subjektet juridike, duke i përfshirë edhe partitë BESA dhe ASH, ndërsa z. Pendarovski me pagesat e anëtarësisë nga LSDM-ja.

bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët.⁵⁸ Pas ndryshimeve të vitit 2018 në Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe në Kodin Zgjedhor, partitë politike mund të marrin kredi bankare, të cilat mund të transferohen në llogaritë e fushatës së kandidatëve. Dy parti politike e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin marrë kredi për fushatën presidenciale, ndërsa kandidatët nuk raportuan se kishin marrë kredi.⁵⁹ Kjo mungesë e rregullativës ndikon negativisht në transparencën e financimit të fushatës.⁶⁰

Për të rritur transparencën dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës, legjislacioni duhet t'i rregullojë aktivitetet e palëve të treta dhe të kërkojë llogaridhënie për shpenzimet e bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët. Kreditë e marra nga partitë politike dhe kandidatët për qëllime të fushatës zgjedhore duhet t'u nënshtrohen kufizimeve dhe kriterëve të ngjashme për raportim sikurse edhe donacionet.

Garuesit duhet të dorëzojnë dy raporte të përkohshme dhe një raport përfundimtar për financimin e fushatës në KSHZ, Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe KSHPK.⁶¹ Raporti i dytë i përkohshëm dorëzohet një ditë para ditës së zgjedhjeve, gjë që nuk ofron kohë të mjaftueshme për publikimin e tij. Ligji i obligon institucionet që i pranojnë raportet t'i publikojnë raportet e përkohshme nga secili garues, megjithatë, këto institucione nuk i shqyrtojnë në hollësi raportet e përkohshme, gjë që e pengon zbulimin e hershëm të parregullsisive. Raportet përfundimtare duhet të dorëzohen në ESHR brenda katër muajve nga zgjedhjet, që është një afat i zgjatur pa nevojë.⁶² Sipas ligjit, ESHR-ja ka 60 ditë për të kryer revizionet, megjithëse ajo nuk e interpreton këtë si afat të fundit për përfundimin e revizionit të raporteve përfundimtare.

Kandidatët në përgjithësi i respektuan kriteret e raportimit për financimin e fushatës, megjithatë, kuptimi i ndryshëm për shpeshësinë dhe formatin e kërkuar rezultuan me raportim jo të njëtrajtshëm.⁶³ Përderisa dy kandidatë dorëzuan dy raporte të përkohshme para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë ashtu siç kërkohet me ligj, znj. Siljanovska Davkova dorëzoi vetëm një raport të përkohshëm.⁶⁴ Për më tepër,

⁵⁸ Llogaritë e partive u nënshtrohen revizioneve vjetore, mirëpo në raportet e tyre nuk paraqiten në mënyrë të veçantë shpenzimet e fushatës në zgjedhjet presidenciale.

⁵⁹ Paragrafi 171 i [Udhëzimit për Rregullativën për Partitë Politike i ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#) (Udhëzimet për Rregullativën për Partitë Politike) rekomandon që rregullat mbi transparencën t'i trajtojnë kreditë në mënyrë konsekuente dhe vlera e tyre të raportohet në mënyrë adekuate në raportet financiare të partive dhe të kandidatëve.

⁶⁰ Neni 7.3 i [Konventës së KB-ve Kundër Korrupsionit të viti 2003](#) kërkon nga vendet që "të konsiderojnë marrjen e masave të përshtatshme legjislative dhe administrative... për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për funksionet e zgjedhura publike dhe, kur është e mundur, financimin e partive politike".

⁶¹ Më 4 mars të vitit 2019, këto tre institucione nënshkruan një memorandum për shkëmbimin e informatave për parregullsitë në raportet financiare dhe për masat pasuese që duhen të ndërmerren.

⁶² Paragrafi 200 i [Udhëzimeve për Rregullativën për Partitë Politike](#) rekomandon që "Raportet për financimin e fushatës duhet t'u dorëzohen autoriteteve përkatëse brenda një periudhe jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve [...] Në përpjekje për ta mbështetur transparencën, është praktikë e mirë që raportet e tilla financiare të vihen në dispozicion në internet në kohë". Sipas ESHR-së, në bazë të revizionit të saj të raporteve për financimin e fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 dhe zgjedhjet lokale të vitit 2017, nuk u gjetën shkelje.

⁶³ Ministria e Financave lëshoi një shabllon të ri për raportim që kërkon ndarje të detajuar të shpenzimeve, duke përfshirë edhe reklamimin e paguar politik, por vetëm z. Pendarovski e përdori atë në rrethin e parë të raportimit. Z. Pendarovski i deklaroi rreth 30 milionë denarë dhe i kishte përfshirë edhe mjetet për reklamat e paguara, ndërsa znj. Siljanovska Davkova dhe z. Reka nuk i kishin përfshirë reklamat e paguara dhe kishin deklaruar rreth 2.2 milionë denarë dhe 1.5 milionë denarë, respektivisht, sipas raporteve të përkohshme.

⁶⁴ Kodi Zgjedhor (neni 84-b) parasheh dorëzimin e raportit të dytë të përkohshëm për gjysmën e dytë të fushatës një ditë pas përfundimit të fushatës.

kandidatët përdorën shabllone të ndryshme për raportim.⁶⁵ Çdo kandidat dorëzoi një raport të përkohshëm para balotazhit.

Enti Shtetëror i Revizionit duhet të ketë mandat për t'i shqyrtuar raportet e përkohshme dhe t'i publikojë menjëherë gjetjet e tij. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare nuk duhet të jetë më i gjatë se një muaj pas zgjedhjeve. Rregullat duhet të qartësojnë strukturën dhe kriteret e raportimit, për të siguruar njëtrajtshmëri të raportimit për financimin e fushatës.

Sipas ligjit, ESHR-ja është organi kryesor mbikëqyrës për financimin politik dhe të fushatave. Institucione të tjera po ashtu kanë kompetenca mbikëqyrëse dhe hetuese mbi financimin e fushatës.⁶⁶ Në praktikë, KSHPK-ja nuk kishte burime për të monitoruar financimin e fushatës gjatë periudhës zgjedhore. Diapazoni i mbikëqyrjes së ESHR-së është i kufizuar në të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara nga garuesit, dhe ESHR-ja nuk ka kompetenca dhe burime të mjaftueshme për të hetuar saktësinë e informatave. Në përgjithësi, mangësitë rregullatore, si dhe kompetencat dhe burimet e kufizuara të institucioneve të përfshira, e zvogëluan transparencën e financimit të fushatës dhe efektivitetin e mbikëqyrjes.⁶⁷

Diapazoni i revizioneve nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) duhet të sigurojë një shqyrtim gjithëpërfshirës të respektimit të rregullave të financimit të fushatës, dhe ESHR-së duhet t'i jepen kompetencat e nevojshme hetimore. Për ta rritur transparencën dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së financimit të fushatës, ESHR-ja duhet t'i ketë burimet dhe ekspertizën e duhur teknike.

⁶⁵ Z. Pendarovski e përdori shabllonin e ri të kërkuar për raportim që përfshinte ndarje të detajuar të shpenzimeve në të dyja rrethet zgjedhore. Znj. Siljanovska Davkova dhe z. Reka fillimisht e përdorën shabllonin e njëjtë të vjetëruar, mirëpo z. Reka e dorëzoi raportin e tij të dytë në shabllonin e ri të kërkuar.

⁶⁶ Sipas ligjit, edhe ESHR-ja edhe KSHPK-ja mund të iniciojnë raste në lidhje me shkeljet e rregullave të financimit të fushatës. Ato mund të përcillen në prokurori. Edhe pse Kodi Zgjedhor (neni 74-a) i urdhëron ESHR-së t'i shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e financimit të fushatës, ESHR-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se nuk kishte kompetencë për t'i shqyrtuar ankesat e tilla.

⁶⁷ Paragrafi 214 i [Udhëzimeve për Rregullativën për Partitë Politike](#) rekomandon se "autoritetit rregullator duhet t'i jepet kompetenca për t'i monitoruar llogaritë dhe për të bërë revizione të raporteve financiare. Procesi [...] duhet të përcaktohet në legjisllacionin përkatës". Shih gjithashtu paragrafin 220, si dhe nenin 7.3 të [Konventës së KB-ve Kundër Korrupsionit](#) të vitit 2003.

X. MEDIAT

A. AMBIENTI MEDIATIK

Ambienti mediatic është i larmishëm, dhe përbëhet, përafërsisht, nga 250 media, duke përfshirë rreth 130 transmetues. Tetë prej tyre, duke i përfshirë edhe tre kanalet publike, janë kanale televizive me mbulim tokësor kombëtar, ndërsa shtatë transmetues të tjerë e mbulojnë gjithë territorin përmes rrjetit kabllovik dhe satelitit. Televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informimit politik.⁶⁸ Në të njëjtën kohë, përhapja gjithnjë e më madhe e internetit ka çuar në një zhvillim të konsiderueshëm të burimeve të informacionit politik në internet (me rreth 100 ueb-faqe të lajmeve), ndërsa rrjetet sociale, veçanërisht Facebook-u, ofrojnë platforma të rëndësishme për diskursin publik. Ekzistojnë gjashtë gazeta ditore që veprojnë në vend.⁶⁹ Në vitin 2018, qeveria futi subvencione për gazetatat me qëllim që ta mbështesë këtë segment tradicional.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së ODIHR-it theksuan përmirësimet në lirinë e mediave në vitet e fundit.⁷⁰ Ligji për Radiodifuzion u ndryshua për të ndaluar reklamimin e fushatave publike përmes mediave transmetuese, që perceptohej gjerësisht si një mekanizëm për blerjen e mbulimit të favorshëm me mjete publike, megjithëse këto të ardhura i mbështetën pjesërisht transmetuesit lokal. Nga ana tjetër, pas heqjes së taksës për radiodifuzion në vitin 2017, transmetuesi publik financohet ekskluzivisht nga buxheti i shtetit.⁷¹ Megjithëse disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se kjo strukturë e financimit mund ta dëmtojë pavarësinë e tij, ata gjithashtu potencuan se ajo përkohësisht mund ta sigurojë stabilitetin e dëshiruar financiar. Pritet që udhëheqja e re e transmetuesit publik të emërohet, siç parashihet me ligj, nga fundi i vitit 2019.

Për të përmirësuar mandatin e shërbimit publik, duke përfshirë edhe aftësinë për raportime hulumtuese dhe analitike, duhet të merret në konsideratë diversifikimi i financimit me qëllim të forcimit të pavarësisë financiare të transmetuesit publik.

Mjedisi mediatic vuan nga një ambient i mbingarkuar i mediave brenda një tregu të kufizuar për reklamim, me një numër të mediave të spikatura private, të financuara nga biznese të afërta me grupet politike, si dhe nga rënia e interesit për profesionin e gazetarisë. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it e theksuan mosrespektimin e vazhdueshëm të standardeve themelore të gazetarisë nga burime të shumta të mediave onlajn, dhe ngritën shqetësime për profesionalizmin dhe qëndrueshmërinë financiare të mediave.

Shteti duhet t'i promovojë publikisht edhe më shumë mekanizmat dhe organet e vetë-rregullimit, të krijuara për mbrojtjen e standardeve profesionale dhe etike të gazetarisë, siç është Këshilli për etikë në media. Përveç kësaj, ai duhet të konsiderojë politika strukturore që synojnë përmirësimin e cilësisë së gazetarisë, duke përfshirë edhe mediat lokale, dhe për t'i forcuar njohuritë elementare mediatike dhe digjitale.

⁶⁸ Në kuadër të transmetuesit publik, *Radio dhe Televizionit të Maqedonisë* (RTM) veprojnë *RTM1*, *RTM2* (programe që transmetohen në gjuhët e pakicave, kryesisht në gjuhën shqipe), një kanal parlamentar dhe tre radiostacione. Në vitin 2018, pesë kanale kryesore private (*Alfa*, *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Sitel*, dhe *Telma*) e themeluan Shoqatën e Mediave të Maqedonisë për t'i mbrojtur interesat e transmetuesve privatë.

⁶⁹ *Slloboden Peçat* është një e përditshme me tirazhin më të madh të deklaruar (rreth 12.000 kopje). Ka edhe dy gazeta të përditshme në gjuhën shqipe.

⁷⁰ Megjithatë, më 17 prill, një ekip mediatic i *TV21* u kërcënua verbalisht dhe u frikësua në Haraçinë. Shih gjithashtu [deklaratën e përfaqësuesit të OSBE-së për lirinë e mediave](#).

⁷¹ Ligji për Radiodifuzion aktualisht parasheh që 0.8 për qind e buxhetit të vendit (me një rritje graduale deri në 1 për qind) të dedikohet për institucionet publike të mediave (RMT-në, Radiodifuzionin e Maqedonisë, i cili e mirëmban rrjetin e transmetuesit publik, dhe Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatika (ASHAAM)). Transmetuesit publik i takon 74.5 për qind, ndërsa ASHAAM-it 6 për qind e kësaj shume.

B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT

Korniza ligjore parasheh rregullim të hollësishëm të sjelljes mediave gjatë fushatës zgjedhore në të dyja rrethet zgjedhore. Megjithatë, dispozita të ndryshme i referohen vetëm mbulimit të partive politike e jo edhe të kandidatëve presidencialë.⁷² Këto dispozita u zbatuan nga KSHZ-ja, në përputhje me marrëveshjen e ndërmjetësuar nga qeveria dhe partitë politike parlamentare, sipas të cilës z. Pendarovski dhe znj. Siljanovska Davkova do të përdornin pjesë të barabarta të reklamave të paguara në media, ndërsa Z. Reka rreth një të tretën e pjesës së tyre. Edhe pse kushtet e dakorduara nuk ishin të barabarta, kandidatët theksuan se ishin të kënaqur me marrëveshjen.

Transmetuesi publik është i obliguar të transmetojë reklama politike falas, ndërsa llojet e tjera të mediave, duke i përfshirë edhe portalet në internet, kanë të drejtë të ofrojnë reklama të paguara politike, të cilat do të kompensohen nga buxheti i shtetit. Mënyra e re, e sapo futur, e kompensimit nga shteti të reklamave politike kishte për qëllim të promovojë qasje më të madhe në media për garuesit. Në të njëjtën kohë, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it e kritikuan përdorimin e mjeteve të konsiderueshme publike për kompensimin e reklamave politike, si dhe mungesën e konsultimeve publike përpara se të zbatohet ky ndryshim.

Të gjitha mediat e interesuara private duhej t'i shpallnin listat me çmimet e tyre për reklamat e paguara politike brenda pesë ditëve nga shpallja e zgjedhjeve. Portalet në internet, po ashtu duhej të regjistroheshin në KSHZ brenda 3 ditëve nga shpallja e zgjedhjeve, për të pasur të drejtë për kompensim.⁷³ Sipas KSHZ-së, 92 transmetues, 83 portale onlajn dhe 6 gazeta i respektuan afatet përkatëse.⁷⁴ KSHZ-ja nuk i mori parasysh mediat që e humbën afatin.⁷⁵

KSHZ-ja i kompensoi shpenzimet për reklama në bazë të faturave të dorëzuara nga mediat, ndërsa në rastin e mediave transmetuese, edhe në bazë të raporteve të monitorimit të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM).⁷⁶ KSHZ-ja i procedoi kompensimet gjatë gjithë periudhës së fushatës, por shumat e mjeteve të paguara për transmetuesit u publikuan vetëm pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë, midis 21 dhe 29 majit.⁷⁷

Nëse do të vazhdohet politika e kompensimit të reklamave politike, ligji duhet të ndryshohet për të paraparë një afat kohor të arsyeshëm dhe real për kompensim.

Kodi Zgjedhor parasheh se transmetuesit që i mbulojnë zgjedhjet janë të obliguar që këtë ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme në të gjitha përmbajtjet e tyre programore. Nga 9 shkurti

⁷² Për shembull Kodi Zgjedhor (neni 75-f.1) parasheh ndarjen e reklamimit të paguar politik vetëm ndërmjet partive politike, në bazë të statusit të tyre (në pushtet, opozitare, parti të tjera parlamentare dhe joparlamentare).

⁷³ Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, mungesa e rregullave themelore për burimet onlajn, të cilat zyrtarisht nuk e kanë statusin e mediave bëri që disa portale të synojnë të marrin mjete publike pa asnjë aktivitet të mëparshëm ose me histori të shpërndarjes së dezinformative, që e vuri në pikëpyetje besueshmërinë e tyre. Një portal i regjistruar në listë ishte vendosur si llogari në "Facebook", ndërsa disa të tjera ishin regjistruar në gjuhë të ndryshme.

⁷⁴ Çdo medie kishte të drejtë të ofrojë reklama të paguara në secilin rreth zgjedhor, sipas zgjedhjes së vet.

⁷⁵ Një medie e tillë, *ITV*, parashtroi ankesë kundër kësaj qasjeje të KSHZ-së, duke pretenduar se ishte e gatshme të paguajë gjobë për afatin e humbur. Ligji parasheh mundësinë e sanksionimit të mediave për shkeljen e afatit, nëse ASHAAM-i fillon procedurë kundërvajtëse, mirëpo ASHAAM-i vendosi të mos bëjë këtë. Gjykata Themelore Shkup 2 kërkoi që KSHZ-ja ta shtonte *ITV* në listën e saj (pasi dy ankesa nga ky kanal u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative) dhe kanali filloi të transmetojë reklama të paguara politike më 14 prill. Pas apelit nga KSHZ-ja, ky vendim u hodh poshtë nga Gjykata e Apelit dhe kërkesa fillestare e kanalit u hodh poshtë nga e njëjta gjykatë themelore më 22 maj.

⁷⁶ ASHAAM-i i monitoroi reklamat e paguara politike në 27 transmetues privatë.

⁷⁷ KSHZ-ja është e obliguar të paguajë dy herë për këto shpenzime: në ditën e 12-të të fushatës zgjedhore, mirëpo jo më vonë se 10 ditë pas përfundimit të fushatës.

e deri në rrethin e dytë, ASHAAM-i e monitoroi respektimin e kritereve për mbulimin e fushatës nga ana e mediave dhe publikoi pesë raporte gjithëpërfshirëse nga monitorimi.⁷⁸ Në përputhje me ligjin, ajo i ofroi KSHZ-së për çdo ditë informata thelbësore nga monitorimi i mediave. Pozitivisht, dhe në kohë, ASHAAM-i identifikoi dhe reagoi ndaj katër shkeljeve të kritereve ligjore dhe gjithashtu i rikujtoi transmetuesit për ndalimin e shfaqjes së fëmijëve në materialet promovuese të garuesve.⁷⁹

C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi se para rrethit të parë transmetuesi publik ka ofruar mbulim të paanshëm, dhe se në përgjithësi mediat kanë prezantuar informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që i mbështetën ata, nëpërmjet programeve të ndryshme dhe pesë debateve televizive me të gjithë kandidatët.⁸⁰ Kjo u ofroi mundësi votuesve që të marrin vendim në bazë të informatave. Përveç debateve, transmetuesi publik emetoi intervista me dy kandidatë, por vendosi të mos emetojë asnjë prezantim tjetër politik falas.⁸¹

Shumica e kanaleve të monitoruara mbuluan të tre kandidatët në mënyrë përafërsisht të barabartë, me informacion dominues neutral.⁸² Televizioni publik *RTMI* i kushtoi z. Pendarovskit rreth 17 për qind, znj. Siljanovska Davkovës 15 për qind, dhe z. Rekës 13 për qind të mbulimit. Edhe kryetarët e LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së u shfaqën rregullisht.⁸³ Përveç kësaj, të gjitha kanalet e monitoruara i kushtuan një pjesë të konsiderueshme të mbulimit politik aktiviteteve të qeverisë (21 deri 37 për qind), duke përfshirë edhe raportime pozitive edhe negative.

Mediat onlajn dhe ato të shkruara ofruan nivele të ndryshme të mbulimit të fushatës, ndërsa në disa raste mungonte ekuilibri në ton dhe mbulim. Për shembull, gazeta *Sloboden Peçat* kishte mbulim kryesisht neutral dhe kritik të znj. Siljanovska Davkova, ndërsa mbulimi i z. Pendarovski dhe z. Reka ishte kryesisht neutral ose pozitiv.⁸⁴ Portali onlajn i lajmeve *kurir.mk* e mbuloi znj. Siljanovska Davkova në mënyrë favorizuese, ndërsa mbulimi i z. Pendarovski ishte kryesisht negativ, kurse i z. Reka neutral. Në shumicën e mediave të monitoruara, garuesit u prezantuan në mënyrë më të balancuar, si në aspekt të hapësirës ashtu edhe në aspekt të tonit.

⁷⁸ ASHAAM-i bëri monitorim sasior dhe cilësor 24 orë në javë, duke përfshirë edhe tonin e mbulimit, të 15 kanaleve televizive para fushatës dhe të 32 kanaleve gjatë fushatës. Ajo publikoi tre raporte para rrethit të parë, dy raporte që e mbulonin periudhën para fushatës dhe një raport që e përfshinte pjesën e parë të fushatës së rrethit të parë. Para balotazhit ajo e publikoi raportin e saj të katërt që e përfshinte pjesën e dytë të fushatës së rrethit të parë. Raporti i pestë që e mbulonte fushatën e balotazhit u publikua një javë pas zgjedhjeve.

⁷⁹ ASHAAM-i filloi katër procedura kundërvajtëse kundër *TV Uskana* me seli në Tetovë, televizionit kombëtar *ITV*, televizionit *TV-M* me seli në Ohër, dhe televizionit *Kobra* me seli në Radovish.

⁸⁰ Monitorimi u bë çdo ditë nga ora 18:00 deri në orën 24:00 në kanalet *RTM1* dhe *RTM2* (në gjuhën maqedonase dhe shqipe, respektivisht) dhe kanalin privat *Alfa* (në gjuhën maqedonase), *Alsat-M* (dygjuhësh), *Kanal 5*, *Sitel*, *Telma* dhe *24 Vesti* (në gjuhën maqedonase). U monitoruan edhe artikujt që kanë të bëjnë me politikën të gazetave *Koha* (në gjuhën shqipe), *Sloboden Peçat*, *Nezavisen* dhe *Nova Makedonija* (në gjuhën maqedonase), si dhe të mediave onlajn www.kurir.mk, www.sdk.mk, www.plusinfo.mk (në gjuhën maqedonase), www.lajmpress.org (në gjuhën shqipe).

⁸¹ Sipas transmetuesit publik, nuk kishte kërkesa të tilla nga garuesit. Megjithëse organizoi debate me të gjithë kandidatët në të dy rrethet zgjedhore, ai transmetoi edhe intervista individuale para rrethit të parë (znj. Siljanovska Davkova vendosi të mos marrë pjesë).

⁸² Si përjashtim, *TV Sitel-i* u përqendrua kryesisht te z. Pendarovski (20 për qind) dhe znj. Siljanovska Davkova (18 për qind), ndërsa z. Reka kishte vetëm rreth 6 për qind të mbulimit.

⁸³ VMRO-DPMNE-ja kishte prej 9 (*Alsat-M*) deri në 19 për qind (*Siteli*) të mbulimit politik, ndërsa LSDM-ja prej 1 (*Alsat-M* dhe *RTM2*) deri në 6 për qind (*Siteli*). Kryetarit të LSDM-së iu kushtua prej 6 (*Siteli*) deri në 10 për qind (*Alfa* dhe *Alsat-M*), në cilësinë e tij si kryeministër.

⁸⁴ Z. Pendarovski kishte 24 për qind të mbulimit politik, znj. Siljanovska Davkova 23 për qind dhe z. Reka 6 për qind.

Në rrethin e dytë, në përgjithësi, shumica e mediave të monitoruara vazhduan të prezantojnë informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që mbështetën ata. Programet e ndryshme politike, reklamat e paguara dhe tre debatet televizive me kandidatët kontribuan që votuesit të kenë mundësi të marrin vendim në bazë të informatave.

Mbulimi i zvogëluar mediatik i rrethit të dytë pasqyroi rënie të aktivitetit të fushatës së kandidatëve.⁸⁵ Pavarësisht nga kjo, shumica a kanaleve të monitoruara i mbuluan garuesit dhe partitë që i mbështesin ata në mënyrë të barabartë, me kohë përafërsisht të barabartë transmetimi dhe me ton të balancuar. Kanalet publike RTM1 dhe RTM2 i kushtuan 28 dhe 18 për qind të mbulimit politik znj. Siljanovska Davkova, respektivisht, dhe 19 dhe 14 për qind z. Pendarovski, me ç'rast të dyja kanalet kishin informata kryesisht neutrale. Megjithatë, kanali privat Alfa edhe pse kishte mbulim të balancuar të kandidatëve, tregoi mbulim negativ të LSDM-së dhe të kryeministrit, kryesisht në programin e saj javor analitik. Portali onlajn *kurir.mk* përsëri prezantoi trajtim preferencial të znj. Siljanovska Davkova dhe të VMRO-DPMNE-së, ndërsa mbulimi i z. Pendarovski dhe i LSDM-së ishte kryesisht negativ. Në kanalet private të monitoruara, mbulimi i aktiviteteve të qeverisë në përgjithësi u zvogëluar në krahasim me rrethin e parë, mirëpo mbulimi i kryeministrit ishte më i madh (ndërmjet 8 dhe 15 për qind), dhe ishte kryesisht me ton neutral.

XI. ANKESAT DHE APELIMET

Korniza ligjore ofron mekanizma për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, por disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, si për shembull ato që kanë të bëjnë me bazën e kufizuar ligjore dhe afatet kufizuese, mbeten të patrajtuara. Sipas Kodit Zgjedhor, KSHZ-ja e trajton shumicën e ankesave në lidhje me zgjedhjet në instancë të parë, ndërsa KSHPK-ja i trajton ankesat në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Gjykatat themelore kanë kompetencë mbi shkeljet zgjedhore.⁸⁶ Shumica e afateve kohore për parashtrimin dhe zgjidhjen e ankesave janë shumë të shkurta, gjë që mund t'i rrezikojë mjetet efektive ligjore.⁸⁷

Afatet për parashtrimin dhe zgjidhjen e ankesave duhet të mundësojnë përgatitje adekuate dhe vendim të peshuar mirë.

Megjithëse, ligji u jep kompetencë KZK-ve të vendosin për ankesat, ai nuk specifikon se cilat ankesa janë nën kompetencën e tyre. Në këto zgjedhje, KZK-të nuk i shqyrtuan ankesat dhe shumë prej tyre i thanë MVZ-së së ODIHR-it se nuk kishin kapacitet ose trajnim për ta bërë këtë.

⁸⁵ Mediat u kushtuan vëmendje të konsiderueshme ngjarjeve të ndryshme nga gara presidenciale, duke përfshirë një mosmarrëveshje për pozitën e kryetarit brenda Bashkësisë Fetare Islame dhe samitin ndërqeveritar të Ballkanit Perëndimor në Berlin.

⁸⁶ Edhe pse Kodi Zgjedhor (neni 73) kandidatëve ua jep të drejtën që drejtpërdrejtë të ngrënë procedurë në gjykatën themelore përkatëse, nëse dikush ndërhyr në fushatat e tyre, në praktikë, sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, individët duhet së pari ta iniciojnë rastin në prokurori dhe nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës. Asnjë rast nuk u parashtrua në gjykatat themelore.

⁸⁷ Shumica e afateve janë 24 ose 48 orë. Për shembull, kundërshtimet për refuzimin e listave të kandidatëve duhet të parashtrohen brenda 24 orëve dhe pastaj të vendoset në lidhje me to brenda 24 orëve. Nga ana tjetër, afati 7-ditor për të vendosur në lidhje me kundërshtimet për zhvillimin e fushatës gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore është shumë i gjatë. Seksioni II.3.3 (95) i [Kodit të Praktikës së Mirë](#) thotë se “afatet kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës së apelimit, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë parashtrimin e apelimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm. Megjithatë, është e lejueshme që t'i jepet pak më shumë kohë [gjykatës më të lartë] për t'i marrë vendimet e saj”.

Për të përmirësuar qasjen në mjetet juridike dhe për të zvogëluar ngarkesën e punës së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, korniza ligjore duhet të specifikojë se cilat ankesa në lidhje me zgjedhjet do të trajtohen nga Komisionet Zgjedhore Komunale, e po ashtu duhet të forcohet edhe kapaciteti i tyre për t'i shqyrtuar ankesat e tilla.

Për vendimet e KSHZ-së në lidhje me ankesat dhe anulimin e rezultateve mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Administrative, e cila është shkalla e fundit në këto raste. Megjithatë, vendimet dhe veprimet e tjera të KSHZ-së nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Ngjashëm, nuk ka shqyrtim gjyqësor në kohë të rregullave të KSHZ-së.⁸⁸ Vetëm garuesit mund t'i kontestojnë parregullsitë e votimit dhe rezultatet e zgjedhjeve. Votuesit mund ta kontestojnë vetëm shkeljen e të drejtës së tyre për të votuar, ndërsa vëzhguesit qytetarë nuk kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa në lidhje me vëzhgimin e tyre.⁸⁹ Përgjigjet me shkrim të KSHZ-së për refuzimin e ankesave të papranueshme nuk konsiderohen si vendime dhe ato nuk mund të apelojnë. Në përgjithësi, korniza ligjore nuk mundëson plotësisht një korrigjim efektiv ligjor, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁹⁰

Korniza ligjore duhet të rishikohet për t'i eliminuar kufizimet e panevojshme të së drejtës për të parashtruar ankesa dhe apelime zgjedhore dhe për të ofruar mjete efektive juridike. Vendimet dhe veprimet e administratës zgjedhore duhet të jenë të arsyetuara dhe t'u nënshtrohen garancive ligjore për shqyrtim gjyqësor në kohë dhe efektiv.

Një numër shumë i vogël i ankesave u parashtruan në KSHZ në periudhën parazgjedhore.⁹¹ KSHZ-ja i shqyrtoi ankesat brenda afatit ligjor, por vendimet nuk kishin arsyetim thelbësor. Sistemi elektronik për ndjekjen e ankesave nga ana e KSHZ-së, që kërkohet nga Kodi Zgjedhor, nuk ishte funksional gjatë gjithë periudhës zgjedhore, gjë që e zvogëloi transparencën e zgjidhjes së ankesave.

KSHZ-ja ka kompetencë t'i trajtojë ankesat në lidhje me parregullsitë në procedurat e ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë proceset e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve, si dhe kontestimin e rezultateve. Për këto vendime të KSHZ-së mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Administrative. Garuesit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa brenda 48 orëve nga publikimi i rezultateve paraprake. Kodi Zgjedhor kërkon që KSHZ-ja t'i anulojë rezultatet e vendvotimeve në rast të parregullsive procedurale, duke përfshirë edhe rastet kur në kutinë e votimit ka fletëvotime të tepërta ose kur votimi ndërpritet për më shumë se tre orë.

⁸⁸ Rregullat mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese, megjithatë, nuk janë paraparë afate të shpejta për shqyrtimin e rasteve të tilla.

⁸⁹ Ankesat e parashtruara nga dy kandidatë të pasuksesshëm në lidhje me procesin e mbledhjes së nënshkrimeve dhe një ankesë nga vëzhguesit civilë në lidhje me zhvillimin e pretenduar të hershëm të fushatës nuk u pranuan sepse sipas ligjit ankuesit nuk kishin të drejtë të parashtrojnë ankesa të tilla.

⁹⁰ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) thotë se "çdonjëri duhet të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për të garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për të siguruar integritetin ligjor". Seksioni II.3.3.3.f i [Kodit të praktikës së mirë](#) rekomandon se "të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet ta kenë të drejtën e ankimit". Shih po ashtu nenin 2.3(a) të KNDP-së të vitit 1996. Shih poashtu Paragrafin 18.2 të [Dokumentit të Moskës të OSBE-së të vitit 1991](#) dhe [Rekomandimin \(2004\)20](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative.

⁹¹ KSHZ-ja pranoi dhe e refuzoi një ankesë në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe tre ankesa në lidhje me zhvillimin e hershëm të fushatës. Gjykata Administrative e vërtetoi vendimin e KSHZ-së për të mos e përfshirë një votues në listën e votuesve për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme dhe vendbanimit zyrtar.

Pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, KSHZ-ja pranoi 14 ankesa për parregullsi, të gjitha të parashtruara nga përfaqësuesit e znj. Siljanovska Davkova.⁹² Duke u bazuar në shqyrtimin e këtyre ankesave, rezultatet e votimit u anuluan në shtatë vendvotime.⁹³ Rezultatet e votimit në një vendvotim tjetër u anuluan me iniciativë të vetë KSHZ-së për shkak të mospërputhjeve në protokollet e rezultateve. Shtatë ankesa të tjera u hodhën poshtë si të pabaza. Edhe pse disa ankesa nuk i plotësonin kriteret formale për dorëzim, pozitivisht, KSHZ-ja megjithatë i shqyrtoi rastet e tilla. Në tre raste KSHZ-ja i shqyrtoi materialet zgjedhore, dhe në dy raste bëri rinumërim e fletëvotimeve.⁹⁴ Përveç kësaj, KSHZ-ja pranoi dhe miratoi pesë ankesa nga votuesit në shtëpi, të cilëve nuk u ishte lejuar të votonin në rrethin e parë. KSHZ-ja vendosi për të gjitha rastet në mbledhje të hapura dhe i publikoi vendimet onlajn, që kontribuoi për transparencë.

Pas balotazhit, KSHZ-ja pranoi 11 ankesa për parregullsi, të gjitha të parashtruara nga përfaqësuesit e znj. Siljanovska Davkova. Këto pretendime përfshinin atë se kishte mospërputhje në protokollet e rezultateve, se votuesit në shtëpi u lejuan të votojnë pa e nënshkruar listën e votuesve, se është votuar në emër të dikujt tjetër, dhe se ka pasur seri nënshkrimesh në dukje identike në listën e votuesve. Duke u bazuar në shqyrtimin e këtyre ankesave, rezultatet e votimit u anuluan në katër vendvotime. Shtatë ankesa u hodhën poshtë si të pabaza. Në nëntë raste KSHZ-ja i shqyrtoi materialet zgjedhore, dhe në pesë raste i rinumëroi fletëvotimet. KSHZ-ja vendosi për të gjitha rastet në mbledhje të hapura dhe i publikoi vendimet onlajn, që kontribuoi për transparencë. Për asnjë nga këto vendime nuk u parashtrua ankesë më tej.

KSHPK-ja pranoi 22 ankesa në lidhje me zgjedhjet, të gjitha nga VMRO-DPMNE-ja ku pretendohet se janë filluar në mënyrë të paligjshme projekte të infrastrukturës, se janë bërë punësime të paligjshme dhe shpenzime të tjera të paligjshme gjatë periudhës së zgjedhjeve. Shumica e këtyre ankesave u hodhën poshtë si të pabaza.⁹⁵ Më tej, KSHPK-ja inicioi shtatë raste *sipas detyrës zyrtare*, në lidhje me fillimin e një projekti infrastrukturor, emërimet dhe promovimet në armatë, dhe ndërprerjen e punësimit pasi u shpallën zgjedhjet. Të gjitha rastet u shqyrtuan brenda afateve ligjore, në mbledhje publike, dhe vendimet u publikuan brenda 24 orëve që ofroi transparencë. Megjithatë, nuk ka afat të caktuar për përfundimin e rasteve që kërkojnë hetime të konsiderueshme. Gjykata Administrative vendosi për apelimet kundër vendimeve të KSHPK-së dhe KSHZ-së brenda afateve ligjore dhe vendimet e saj u publikuan në internet në kohën e duhur.⁹⁶

XII. VËZHGESIT CIVILË DHE NDËRKOMBËTARË

Për të kontribuar për transparencën e procesit zgjedhor, Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgimin e të gjitha fazave nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, si dhe nga përfaqësuesit e garuesve në zgjedhje. Procesi i akreditimit të vëzhguesve qytetarë është i centralizuar dhe organizatat e akredituara janë të renditura në ueb-faqen e KSHZ-së, ndërsa përgjegjësia për regjistrimin e përfaqësuesve të kandidatëve u takon KZK-ve. Distinktivët e lëshuar për vëzhguesit dhe përfaqësuesit e kandidatëve nuk tregojnë se

⁹² Parregullsitë e pretenduara përfshinin atë se votuesve u janë dhënë fletëvotime shtesë ose fletëvotime me bllok, se njerëzve që nuk janë në listën e votuesve u është lejuar të votojnë, se fletëvotimet e pavlefshme janë përcaktuar në mënyrë të gabuar dhe se është bërë mbushja e kutive të votimit.

⁹³ Në gjashtë vendvotime rezultatet u anuluan për shkak se në kuti u gjet një fletëvotim më tepër.

⁹⁴ Korniza ligjore nuk i rregullon procedurat e rinumërimit.

⁹⁵ Nëntë u hodhën poshtë, dy u vërtetuan pjesërisht dhe një u vërtetua plotësisht. Një kundërshtim u dërgua në Prokurorinë Publike për hetimin e një vepre të mundshme penale.

⁹⁶ Gjykata i hodhi poshtë dy padi të tilla nga një medie, e cila e humbi afatin për shpalljen e listës së çmimeve dhe për këtë arsye nuk u miratua nga KSHZ-ja për reklamim të paguar politik, dhe i vërtetoi dy vendime të KSHZ-së për të mos i përfshirë votuesit në listën e votuesve për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme dhe vendbanimit zyrtar. Dy apelimet kundër vendimeve të KSHPK-së për fillimin e procedurave u pranuan dhe në dy raste gjykata i rrëzoi vendimet e KSHPK-së për fillimin e procedurave.

kë e përfaqësojnë ata. Në disa raste, vëzhguesit e MNVZ-së panë se përfaqësuesit e kandidatëve i plotësonin vetë distinktivët e tyre.

Duke pasur parasysh numrin e madh të kërkesave për t'i vëzhguar zgjedhjet, KSHZ-ja e zgjati periudhën e aplikimit për akreditim para rrethit të parë, e pastaj kjo periudhë u zgjat edhe më shumë, pa caktuar afat përfundimtar, për balotazhin. Akreditimet e rrethit të parë mbetën të vlefshme edhe në rrethin e dytë. Në një proces inkluziv, KSHZ-ja akreditoi gjithsej 3.381 vëzhgues qytetarë dhe 520 vëzhgues ndërkombëtarë për të dy rrethet zgjedhore. Në grupet e vëzhguesve civilë bënë pjesë "CIVIL" dhe Shoqata qytetare "MOST", të cilat po ashtu bënë nxjerrjen paralele të rezultateve të votimit.⁹⁷ Disa organizata të personave me aftësi të kufizuara, si për shembull "Inkluziva", po ashtu i vëzhguan zgjedhjet.

XIII. DITA E ZGJEDHJEVE

A. RRETHI I PARË

Me 21 prill, votimi u zhvillua në 3.395 vendvotime në vend.98 Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe vendvotimet u administruan mirë. MNVZ-ja e vëzhgoi hapjen në 93 vendvotime, votimin në 979 vendvotime, numërimin në 87 vendvotime dhe nxjerrjen e rezultateve në 69 KZK.

Votimi i hershëm u mbajt një ditë më parë, më 20 prill, për votuesit në shtëpi, personat e zhvendosur në brendi të vendit, votuesit në institucionet ndëshkuese dhe në një shtëpi pleqsh dhe në një spital special në Shkup. Në të njëjtën ditë, votimi u zhvillua edhe në vendvotimet jashtë vendit. MNVZ-ja e vëzhgoi votimin në 12 institucione ndëshkuese dhe në shtëpinë e pleqve. Votimi në këto institucione kaloi në mënyrë të rregullt dhe u vlerësua pozitivisht në të gjitha vëzhgimet. Rastet e votuesve që nuk gjendeshin në listat e votuesve në burgje e theksuan nevojën për përditësimin në kohë të këtyre listave. Disa votues nuk kishin letërnjoftime të vlefshme dhe atyre iu lejua të votojnë me dokumentet e identifikimit të burgut.

Në ditën e zgjedhjeve, hapja u vlerësua pozitivisht në pothuajse të gjitha vendvotimet e vëzhguara. Këshillat zgjedhorë në përgjithësi ishin të vetëdijshëm për procedurat dhe punuan në mënyrë transparente, megjithëse u vërejtën disa parregullsi, si për shembull mos tregimi i kutisë së zbrazët të votimit (12 raste) ose mosplotësimi i protokollit para fillimit të votimit (19 raste). Tetëmbëdhjetë nga vendvotimet e vëzhguara u hapën me një vonesë të shkurtër.

Gjatë gjithë ditës, vëzhguesit e vlerësuan procesin e përgjithshëm si transparent, i cili u mbështet nga prania e vëzhguesve qytetarë (39 për qind e vëzhgimeve) dhe e përfaqësuesve të kandidatëve (70 për qind). Realizimi i votimit u vlerësua pozitivisht nga MNVZ-ja në 99 për qind të vëzhgimeve. Procesi i votimit kaloi pa pengesa dhe procedurat u ndoqën në pothuajse të gjitha vëzhgimet, duke përfshirë kontrollimin e dokumenteve të identifikimit të votuesve, sigurimin se votuesit nënkruhen në listën e votuesve dhe shënimin me ngjyrë të gishtave të votuesve. Vëzhguesit vunë re se anëtarët e KZ-ve jo gjithmonë i udhëzuan votuesit se si t'i shënojnë fletëvotimet në mënyrë adekuate.

⁹⁷ "MOST" shpërndau 2.030 vëzhgues në të dy rrethet, ndërsa "CIVIL", 162.

⁹⁸ Në bazë të një vendimi të KSHZ-së të datës 8 prill, nuk u krijuan 2 vendvotime ku nuk kishte votues të regjistruar dhe 82 vendvotime me më pak se 10 votues të regjistruar në 28 komuna u zhvendosën në vendvotimet e afërta, por me material të veçantë zgjedhor (shih gjithashtu *Rrethi i dytë*). Një vendvotim në komunën e Studeniçanit nuk u hap për shkak të protestës së një banori lokal.

Në përgjithësi, nuk u vërejtën shkelje të mëdha në ditën e zgjedhjeve. Megjithatë, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re raste të votimit në grup dhe të votimit familjar (3 për qind e vëzhgimeve), të cilat kryesisht ndikojnë në mundësinë e grave për ta hedhur votën e tyre lirisht dhe në fshehtësi.

Megjithëse KSHZ-ja morri masa për ta rritur numrin e vendvotimeve pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara përpara këtyre zgjedhjeve, hapësirat e vendvotimeve u vlerësuan se ishin të përshtatshme që personat me aftësi të kufizuara të hyjnë në mënyrë të pavarur në vetëm 46 për qind të vëzhgimeve.⁹⁹ Në 80 për qind të vëzhgimeve, organizimi i hapësirës së vendvotimit ishte e përshtatshëm për votuesit me aftësi të kufizuara, dhe pothuajse të gjitha vendvotimet e vëzhguara ishin të pajisura me shabllon me alfabet të Brejtit. Në disa raste, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re se procedurat për t'u ndihmuar votuesve me aftësi të kufizuara nuk u respektuan, që disa herë rezultoi me votim nga dikush tjetër në emrin e tyre.

Për të lehtësuar pjesëmarrjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuara fizike në zgjedhje, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse shtetërore, duhet të vazhdojë të marrë masa për të përmirësuar hyrjen e personave me aftësi të kufizuara fizike në vendvotime dhe për të trajnuar stafin e vendvotimeve për përdorimin e mjeteve ndihmëse për këta persona.

Numërimi, në përgjithësi, u vlerësua pozitivisht, megjithëse MNVZ-ja vërejtë se jo të gjitha KZ-të i ndoqën procedurat dhe shpesh nuk zbatuan masa të rëndësishme mbrojtëse, siç është përcaktimi i numrit të fletëvotimeve të përdorura (19 vëzhgime) dhe përcaktimi i numrit të votuesve që u nënshkruan në listën e votuesve (17 vëzhgime) para hapjes së kutisë së votimit.

Asnjë shqetësim nuk u ngrit në lidhje me saktësinë e numërimit të votave, ndërsa vlefshmëria e votave u përcaktua kryesisht në mënyrë konsekuente. Numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme (duke i përfshirë edhe fletëvotimet e pashënuara) në rrethin e parë KSHZ-ja ia atribuoi prishjes së qëllimshme të fletëvotimeve nga qytetarët, të cilët kështu e shprehën qëndrimin e tyre politik, e jo mosdijes se si ta shënojnë fletëvotimin.¹⁰⁰ Pavarësisht nga kjo, ligji është i paqartë në përcaktimin e fletëvotimeve të pavlefshme. Kodi Zgjedhor parashihet se rrethimi i numrit të kandidatit është mënyra e vetme e vlefshme për ta shënuar fletëvotimin, ndërsa po ashtu përcakton se fletëvotimi duhet të konsiderohet i vlefshëm nëse vullneti i votuesit mund të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë. Në udhëzimet e saj, KSHZ-ja po ashtu e pranoi edhe rrethimin e emrit ose simbolit të kandidatit. Gjithashtu, çdo vendvotim e pranoi numrin e njëjtë të fletëvotimeve sikurse edhe numri i votuesve të regjistruar, ndërsa KZ-të u udhëzuan që të mos u japin fletëvotime të reja votuesve që i prishnin fletëvotimet e tyre pa qëllim.

Duhet konsideruar mundësia e qartësisht të rregullave për ta ruajtur vlefshmërinë e fletëvotimeve që e shprehin qartë vullnetin e votuesit. Po ashtu duhet konsideruar mundësia që të lejohet zëvendësimi i fletëvotimeve të prishura rastësisht.

Procedurat përgjithësisht u ndoqën gjatë nxjerrjes së rezultateve në KZK dhe procesi u vlerësua pozitivisht në të gjitha vëzhgimet, përveç në një rast. Vëzhguesit vunë në dukje se praktikat e KZK-ve

⁹⁹ KSHZ-ja siguroi fito platforma të lëvizshme për hyrje të personave me aftësi të kufizuara dhe dy transportues me shkallë për karroca invalidore. Në vitin 2017, KSHZ-ja bëri vlerësim të 2.733 hapësirave të vendvotimeve në objektet publike sa i përket mundësisë për hyrje të votuesve me aftësi të kufizuara dhe zbuloi se 51 për qind e këtyre hapësirave ishin të pajisura me platforma hyrëse, mirëpo, platformat shpesh nuk ishin mjaft të forta ose të gjera për një karrocë të rregullt invalidore.

¹⁰⁰ Në rrethin e parë, 4,3 për qind e fletëvotimeve të hedhura u vlerësuan të pavlefshme. Përqindjet më të larta u regjistruan në ÇuçerSandevë, Makedonska Kamenicë dhe Delçevë, edhe atë 7.7, 6.5, dhe 6.2 për qind, përkatësisht.

në lidhje me zgjidhjen e mospërputhjeve në të dhënat e protokolleve të KZ-ve ndryshonin, gjë që tregoi se kishte mungesë të udhëzimeve adekuata nga KSHZ-ja për këtë çështje.

KSHZ-ja e informoi publikun për pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje gjashtë herë gjatë ditës së zgjedhjeve dhe filloi t'i publikojë rezultatet paraprake në ueb-faqen e saj në mënyrë të vazhdueshme në më pak se një orë pas mbylljes së vendvotimeve, të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve, që ofroi një shkallë të lartë të transparencës. KSHZ-ja i shpalli rezultatet përfundimtare të rrethit të parë më 25 prill, me ç'rast pjesëmarrja e votuese në nivel kombëtar ishte 41.7 për qind.¹⁰¹ Pasi asnjëri nga tre kandidatët nuk i fitoi votat e nevojshme të shumicës së votave për t'u zgjedhur në rrethin e parë, dy kandidatët me numrin më të madh të votave, kaluan në rrethin e dytë që u mbajt më 5 maj.

B. RRETHI I DYTË

Dita e zgjedhjeve të rrethit të dytë kaloi pa pengesa dhe u administrua mirë. Përfaqësuesit e kandidatëve ose vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm në shumicën e vendvotimeve të vëzhguar, gjë që kontribuoi për transparencën e procesit. Sikurse në rrethin e parë, gratë ishin të përfaqësuara mirë në organet e ndryshme zgjedhore, me ç'rast ato përfaqësonin rreth dy të tretat e të gjithë anëtarëve dhe dy të tretat e kryetarëve në këshillat zgjedhorë.

Votuesit të cilët u regjistruan për votim jashtë vendit ose për votim në shtëpi për rrethin e parë u përfshinë automatikisht në këto lista të votuesve edhe për rrethin e dytë, e po ashtu deri më 27 prill u pranuan kërkesat shitesë për votim në shtëpi. Këta votues, si edhe votuesit në institucionet ndëshkuese votuan një ditë më parë, më 4 maj. Në të gjitha 13 vëzhgimet e MNVZ-së, procesi i votimit të hershëm ishte i rregullt dhe procedurat kryesisht u ndoqën. Në një vëzhgim, u shprehën shqetësime në lidhje me fshehtësinë, për shkak se zarfet me fletëvotimet nuk ishin mbyllur si duhet. Sikurse në rrethin e parë, disa votues nuk kishin mundësi të votojnë për shkak se nuk ishin në lista ose nuk i kishin dokumentet e nevojshme të identifikimit.

Në ditën e zgjedhjeve, hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha 64 vendvotimet e vëzhguara. KZ-të i kishin të njohura procedurat dhe kryesisht i ndoqën ato, edhe pse në 12 raste KZ-të nuk i plotësuan protokollat para fillimit të votimit. Shumica e vendvotimeve u hapën në kohë ose me një vonesë të shkurtër. Në një vëzhgim, hapja u shty për më shumë se një orë për shkak të zëvendësimit të listave të votuesve që ishin shtypur gabimisht.

Votimi ishte i organizuar mirë dhe procesi u vlerësua pozitivisht në 99 për qind të vëzhgimeve të MNVZ-së. Procedurat kyçe u ndoqën gjatë gjithë ditës, duke përfshirë edhe kontrollimin dhe shënimin me ngjyrë të gishtave të votuesve, kontrollimin e letërnjoftimeve, dhe nënshkrimin në listat e votuesve. Një numër shumë i vogël i vlerësimeve negative kishte të bëjë me hapësirat joadekuata për votim, të cilat nuk ishin të përshtatshme për votim dhe në disa raste e komprometuan fshehtësinë e votës. Sikurse në rrethin e parë, u vërejtën raste të votimit familjar (në 3 për qind të vëzhgimeve), gjë që kryesisht ndikon negativisht mbi gratë. Prosesi i votimit në përgjithësi ishte transparent, edhe pse në disa raste vëzhguesve të MNVZ-së nuk iu lejua ta shihnin listën e votuesve. Gjatë ditës, MNVZ-ja pranoi disa pretendime të besueshme për blerje të votave, e cila po ashtu vërejtë indikacione të qarta të blerjes së votave në Shtip dhe Strumicë.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe aktorët e tjerë duhet t'i vazhdojnë përpjekjet për edukimin e votuesve dhe edukimin qytetar për të parandaluar votimin familjar dhe për të ruajtur të drejtën për zgjedhje të lirë për çdo votues. Këto përpjekje edukative gjithashtu duhet të trajtojnë blerjen e votave, ndërsa organet e zbatimit të ligjit duhet t'i hetojnë pretendimet për blerjen e votave dhe t'i marrin në përgjegjësi organizatorët e tyre.

¹⁰¹ Një korrigjim shumë i vogël i këtyre rezultateve u miratua më 3 maj.

Megjithëse hapësirat e vendvotimeve mundësonin hyrje të pavarur të personave me aftësi të kufizuara në vetëm 41 për qind të vëzhgimeve, në 82 për qind të vëzhgimeve organizimi i hapësirës brenda vendvotimeve u vlerësua si i përshtatshëm për votuesit me aftësi të kufizuara. Sikurse në rrethin e parë, për votuesit me shikim të dobësuar shabllon me alfabet të Brejit kishte në të gjitha vendvotimet përveç se në nëntë prej tyre, edhe pse bashkëbiseduesit e MNVZ-së theksuan se këto pajisje u përdorën rrallë.

Numërimi u vëzhgua në 71 vendvotime. Edhe pse ai u bë në mënyrë efikase, vëzhguesit vërejtën se kjo u bë me ngut dhe në shumicën e rasteve KZ-të nuk i kryen procedurat e parapara para hapjes së kutive të votimit, duke përfshirë numërimin e nënshkrimeve në listat e votuesve (20 raste), konstatimin e numrit të fletëvotimeve të shfrytëzuara (20 raste), dhe prishjen e fletëvotimeve të mbetura si të papërdorshme (14 raste). Vetë procedurat e numërimit të votave u respektuan mirë, me ç'rast fletëvotimet u numëruan saktësisht dhe fletëvotimet e pavlefshme u përcaktuan në mënyrë konsekuente. Transparenca e numërimit u përmirësua me prezencën e përfaqësuesve të kandidatëve (59 raste) dhe të vëzhguesve qytetarë (16 raste), mirëpo KZ-të nuk publikuan në 29 raste kopje të protokolleve me rezultatet në vendvotime.

Sikurse në rrethin e parë, në vendvotimet me më pak se 10 votues të regjistruar, fshehtësia e votës u komprometua, pasi zgjedhja që e kishte bërë votuesi mund të zbulohet gjatë numërimit, që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.¹⁰² Megjithëse KSHZ-ja i zhvendosi votuesit e këtyre vendvotimeve në vendvotimin më të afërt, këto vendvotime nuk u bashkuan dhe votat u hodhën në kuti të veçanta të votimit dhe u numëruan veçmas. Në mënyrë të ngjashme, kur një numër i vogël i votave nga institucionet ndëshkuese dhe personat e zhvendosur në brendi të vendit numërohen në KZK, zgjedhja që e kanë bërë këta votues gjithashtu mund të zbulohet.

Për të siguruar fshehtësinë e votës, vendvotimet me më pak se dhjetë votues duhet të bashkohen me vendvotimet e afërta dhe fletëvotimet e tyre të mbliidhen së bashku. Procedurat për numërimin e votave nga institucionet ndëshkuese dhe institucionet e tjera duhet të ruajnë fshehtësinë e zgjedhjeve të bëra nga votuesit.

Nxjerrja e rezultateve u vlerësua pozitivisht në të gjitha 61 KZK-të e vëzhguara. Megjithëse vëzhguesit vërejtën organizim të mirë të procesit, hapësirat u vlerësuan si joadekuate në katër raste. Mospërputhjet në protokollat me rezultatet kryesisht u zgjodhën nga KZK-të, duke e rishqyrtuar materialin zgjedhor, megjithatë, në disa raste nga KZ-të u kërkua që rinumërimin të bëjnë vetë ata, gjë që e potencoi mungesën e udhëzimit të njëtrajtshëm për këtë fazë të procesit.

KSHZ-ja publikoi informata për pjesëmarrjen e votuesve gjatë gjithë ditës dhe i publikoi rezultatet e përkohshme ashtu siç përpunoheshin, ndërsa rezultatet e plota të përkohshme ishin në dispozicion para mesnatës, të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve. KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja e votuesve ishte 46.7 për qind. Akuza për parregullsi u emetuan gjatë ditës nga VMRO-DPMNE-ja, e cila po ashtu pretendoi se votuesit padrejtësisht ndikoheshin nga partitë në pushtet. Ministri i punëve të brendshme raportoi parregullsi të izoluar. Pavarësisht nga kjo, të dy kandidatët e pranuan rezultatit e zgjedhjeve në natën e zgjedhjeve.

XIV. ZHVILLIMET PAS ZGJEDHJEVE

¹⁰² Shih KNDCP, neni 25: "Çdo qytetar duhet të ketë të drejtën dhe mundësinë... të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje të rregullta periodike të cilat... duhet të mbahen me votim të fshehtë, duke e garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve." Paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së kërkon që vendet pjesëmarrëse të OSBE-së "të sigurojnë se votat do të hidhen me fletëvotime të fshehta ose me procedurë ekuivalente për votim të lirë".

Rezultatet përfundimtare u shpallën nga KSHZ-ja më 11 maj, në mbledhjen pas së cilës iu dha certifikata kryetarit të sapozgjedhur, Z. Pendarovski. Për herë të parë, përveç në gjuhën maqedonase certifikata ishte shkruar edhe në gjuhën shqipe. Z. Pendarovski u inaugurua si kryetar i vendit nga Kuvendi më 12 maj. Atmosfera pas zgjedhjeve ishte e qetë dhe paqësore. Pas zgjedhjeve, kryeministri deklaroi se zgjedhjet kishin qenë të suksesshme dhe demokratike dhe se vendi ishte i përgatitur për integrim në Evropë. Kryetari i VMRO-DPMNE-së, megjithëse shprehu kënaqësinë që znj. Siljanovska Davkova kishte fituar numrin më të madh të votave në shumicën e komunave, e përsëriti pohimin e tij të mëparshëm se ajo mund të kishte humbur vetëm si rezultat i mashtrimit zgjedhor, megjithëse nuk ofroi asnjë dëshmi e as nuk parashtroi ndonjë ankesë.

XV. REKOMANDIMET

Këto rekomandime ashtu siç janë paraqitur përgjatë gjithë raportit, ofrohen me qëllim që të përmirësohet edhe më shumë zhvillimi i zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut dhe që të mbështeten përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, të cilat ende nuk janë trajtuar.¹⁰³ OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'u ndihmojë autoriteteve të Maqedonisë së Veriut për të përmirësuar edhe më shumë procesin zgjedhor dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Duhet të bëhet një rishikim gjithëpërfshirës i legjislacionit zgjedhor për t'i trajtuar mangësitë e identifikuara në këtë dhe në raportet e mëparshme të ODIHR-it. Rregullat e fushatës dhe të mediave duhet ta rregullojnë garën presidenciale dhe të sigurojnë mundësi të barabarta për kandidatët. Duhet të sqarohen rregullat për rrethin e dytë. Procesi i reformës duhet të jetë publik, inkluziv dhe të kryhet në një periudhë kohore të mjaftueshme para zgjedhjeve të ardhshme.
2. Duhet konsideruar mundësia për të rishikuar pragun ekzistues të pjesëmarrjes së votuesve për zgjedhjet presidenciale për të minimizuar rrezikun e zgjedhjeve të dështuara. Korniza ligjore mund të ndryshohet për të llogaritur shumicën fituese në rrethin e parë nga numri i votave të hedhura, ndërsa kriteri për pjesëmarrje të votuesve në rrethin e dytë mund të hiqet.
3. Për të siguruar stabilitet dhe profesionalizëm të administratës zgjedhore, duhet të miratohen dispozita ligjore të cilat e përcaktojnë qartë përbërjen dhe kohëzgjatjen e mandatit të një Komisioni të përhershëm Shtetëror Zgjedhor. Personeli kryesor i sekretariatit të KSHZ-së duhet të punësohet në baza të përhershme.

¹⁰³ Në paragrafin 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”. Ndjekja e rekomandimeve paraprake nga MVZ-ja e ODIHR-it është vlerësuar si më poshtë: rekomandimet 5, 6, 12, 16, 19, 26, 30 dhe 31 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2009, 17 dhe 24 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2014, dhe 11, 19, 21 dhe 22 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2016 janë zbatuar plotësisht. Rekomandimet 9, 18 dhe 22 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2009, 7, 13, 14, 16, 19, 20, 21, dhe 22 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2014, 2, 8, 23 dhe 25 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2016, si dhe 6 dhe 10 nga raporti përfundimtar për referendumin e vitit 2018 kryesisht janë zbatuar. Rekomandimet 1, 2, 3, 7, 8, 10, 11, 14, 15, 17, 23, 25, dhe 29 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2009, 1, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 18 dhe 25 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2014, 1, 6, 13, 14, 15, 20, 26 dhe 29 nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2016, dhe 2, 11, 12 dhe 14 nga raporti përfundimtar për referendumin e vitit 2018 janë trajtuar pjesërisht. Shih gjithashtu www.paragraph25.odihr.pl.

4. Autoritetet shtetërore duhet të vazhdojnë me përpjekje të koordinuara dhe sipas përgjegjësisë të përcaktuara qartë, të bëjnë përditësimin dhe harmonizimin e të gjithë regjistrave dhe bazave përkatëse të të dhënave për të siguruar një bazë të saktë për regjistrin e votuesve.
5. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme energjike për t'iu kundërvënë çdo formë të presionit ndaj punonjësve të sektorit publik, duke përfshirë edhe deklaratat e qarta publike dhe udhëzimet me shkrim nga funksionarët e lartë të shtetit se një presion i tillë nuk do të tolerohet dhe se asnjë qytetar nuk duhet të ketë frikë nga pasojat negative si rezultat i mbështetjes ose mos mbështetjes së ndonjë kandidati apo partie. Punonjësit e sektorit publik duhet të inkurajohen në mënyrë aktive që të denoncojnë çdo rast presioni, dhe rastet e tilla duhet të hetohen plotësisht dhe të ndiqen penalisht, duke i mbrojtur ata që i denoncojnë këto raste.
6. Enti Shtetëror i Revizionit duhet të ketë mandat për të shqyrtuar raportet e përkohshme dhe të publikojë menjëherë gjetjet e tij. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare nuk duhet të jetë më i gjatë se një muaj pas zgjedhjeve. Rregullat duhet të qartësojnë strukturën dhe kriteret e raportimit, për të siguruar njëtrajshmëri të raportimit për financimin e fushatës.
7. Diapazoni i revizioneve nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) duhet të sigurojë një shqyrtim gjithëpërfshirës të respektimit të rregullave të financimit të fushatës, dhe ESHR-së duhet t'i jepen kompetencat e nevojshme hetimore. Për ta rritur transparencën dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së financimit të fushatës, ESHR-ja duhet të ketë burimet dhe ekspertizën e duhur teknike.
8. Korniza ligjore duhet të rishikohet për t'i eliminuar kufizimet e panevojshme të së drejtës për të parashtruar ankesa dhe apelime zgjedhore dhe për të ofruar mjete efektive juridike. Vendimet dhe veprimet e administratës zgjedhore duhet të jenë të arsyetuara dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor në kohë dhe efektiv.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Administrata zgjedhore

9. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të hartojë udhëzime gjithëpërfshirëse për sigurinë kibernetike për gjithë personelin dhe sistemet që menaxhojnë ose përmbajnë të dhëna zgjedhore. Ai duhet të mbajë trajnime për të gjithë anëtarët dhe punonjësit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të Komisioneve Zgjedhore Komunale për zbutjen e rreziqeve dhe për trajtimin e incidenteve të mundshme të sigurisë kibernetike.
10. Për ta rritur transparencën dhe vetëdijen publike, Komisionet Zgjedhore Komunale duhet t'i publikojnë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve në kohë dhe në mënyrë konsekuente. Për këtë qëllim duhet të sigurohen mjete përkatëse, si për shembull qasje në ueb-faqet e komunave ose në platformat e tyre në rrjetet sociale.
11. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, të dhënat e zberthyera për përfaqësimin gjinor dhe etnik që u përgatitën gjatë procesit zgjedhor duhet të publikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.
12. Për të rritur ushtrimin efektiv të së drejtës për votim, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një program në kohë, gjithëpërfshirës dhe që synon edukimin e votuesve, duke përfshirë informata për regjistrimin e votuesve dhe procedurat për parashtrim të ankesave.

Regjistrimi i votuesve

13. Siç është rekomanduar më parë, legjislacioni duhet të harmonizohet me qëllimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke i hequr të gjitha kufizimet e të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale.
14. Për të përmirësuar saktësinë e listave të votuesve dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e votuesve, duhet konsideruar mundësia për zgjatjen e periudhës së këqyrjes publike të listave të votuesve dhe për vendosjen e afatit të fundit për bërjen e ndryshimeve më afër ditës së zgjedhjeve. Po ashtu mund të konsiderohet mundësia për përditësimin e regjistrit të votuesve ndërmjet rrethëve zgjedhore.
15. Votuesit me të drejtë vote nuk duhet të përjashtohen nga regjistri i votuesve për shkak të dokumenteve të skaduar. Duhet të ndërmerren masa legjislative dhe administrative për t'i mundësuar secilit që ka të drejtë të votojë ta ushtrojë këtë të drejtë në mënyrë efektive.

Regjistrimi i kandidatëve

16. Duhet konsideruar mundësia për zgjatjen e periudhës kohore për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidatëve potencialë.

Fushata zgjedhore

17. Duhet konsideruar mundësia e përshtatjes së periudhës zyrtare të fushatës me periudhën kohore për regjistrimin e garuesve, për të siguruar se rregullat e fushatës vlejné në mënyrë konsekuente për të gjithë pjesëmarrësit. Aktivitetet politike para periudhës zyrtare të fushatës nuk duhet të jenë të jashtëligjshme.

Financimi i fushatës

18. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit duhet të pajiset me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të realizuar në mënyrë efektive mandatin e tij gjatë periudhës zgjedhore.
19. Për të rritur transparencën dhe mbikëqyrjen e financimit të fushatës, legjislacioni duhet t'i rregullojë aktivitetet e palëve të treta dhe të kërkojë llogaridhënie për shpenzimet e bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët. Kreditë e marra nga partitë politike dhe kandidatët për qëllime të fushatës zgjedhore duhet t'u nënshtrohen kufizimeve dhe kritereve të ngjashme për raportim sikurse edhe donacionet.

Mediat

20. Për të përmirësuar mandatin e shërbimit publik, duke përfshirë edhe aftësinë për raportime hulumtuese dhe analitike, duhet të merret në konsideratë diversifikimi i financimit me qëllim të forcimit të pavarësisë financiare të transmetuesit publik.
21. Shteti duhet t'i promovojë publikisht edhe më shumë mekanizmat dhe organet e vetë-rregullimit, të krijuara për mbrojtjen e standardeve profesionale dhe etike të gazetarisë, siç është Këshilli për etikë në media. Përveç kësaj, ai duhet të konsiderojë politika strukturore që synojnë përmirësimin e cilësisë së gazetarisë, duke përfshirë edhe mediat lokale, dhe për t'i forcuar njohuritë elementare mediatike dhe digjitale.
22. Nëse do të vazhdohet politika e kompensimit të reklamave politike, ligji duhet të ndryshohet për të paraparë një afat kohor të arsyeshëm dhe real për kompensim.

Ankesat dhe apelimet

23. Afatet për parashtrimin dhe zgjidhjen e ankesave duhet të mundësojnë përgatitje adekuate dhe vendim të peshuar mirë.
24. Për të përmirësuar qasjen në mjetet juridike dhe për të zvogëluar ngarkesën e punës së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, korniza ligjore duhet të specifikojë se cilat ankesa në lidhje me zgjedhjet do të trajtohen nga Komisionet Zgjedhore Komunale, e po ashtu duhet të forcohet edhe kapaciteti i tyre për t'i shqyrtuar ankesat e tilla.

Dita e zgjedhjeve

25. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuara fizike në zgjedhje, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse shtetërore, duhet të vazhdojë të marrë masa për të përmirësuar hyrjen e personave me aftësi të kufizuara fizike në vendvotime dhe për të trajnuar stafin e vendvotimeve për përdorimin e mjeteve ndihmëse për këta persona.
26. Duhet konsideruar mundësia e qartësimit të rregullave për të ruajtur vlefshmërinë e fletëvotimeve që shprehin qartë vullnetin e votuesit. Po ashtu duhet konsideruar mundësia që të lejohet zëvendësimi i fletëvotimeve të prishura rastësisht.
27. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe aktorët e tjerë duhet t'i vazhdojnë përpjekjet për edukimin e votuesve dhe edukimin qytetar për të parandaluar votimin familjar dhe për të ruajtur të drejtën për zgjedhje të lirë për çdo votues. Këto përpjekje edukative gjithashtu duhet të trajtojnë blerjen e votave, ndërsa organet e zbatimit të ligjit duhet t'i hetojnë skemat për blerjen e votave dhe t'i marrin në përgjegjësi organizatorët e tyre.
28. Për të siguruar fshehtësinë e votës, vendvotimet me më pak se dhjetë votues duhet të bashkohen me vendvotimet e afërta dhe fletëvotimet e tyre të mblidhen së bashku. Procedurat për numërimin e votave nga institucionet ndëshkuese dhe institucionet e tjera duhet të ruajnë fshehtësinë e zgjedhjeve të bëra nga votuesit.

ANEKSI I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE¹⁰⁴

Numri i votuesve të regjistruar në listën e votuesve	1.808.131
Numri i votuesve të regjistruar në listën për votim në vend	1.726.696
Numri i votuesve të regjistruar në listën e votuesve që banojnë përkohësisht jashtë vendit	77.579
Numri i votuesve të regjistruar për votim jashtë vendit.	1.781

RRETHI I PARË

Numri i votuesve që votuan	753.556	41,68%
Numri i fletëvotimeve të pavlefshme	32.697	4,34%

Blerim Reka	79.888	10,60%
Gordana Siljanovska Davkova	318.341	42,25%
Stevo Pendarovski	322.581	42,81%

RRETHI I DYTË

Numri i votuesve që votuan	843.508	46,65%
Numri i fletëvotimeve të pavlefshme	30.406	3,60%

Gordana Siljanovska Davkova	377.446	44,75%
Stevo Pendarovski	435.656	51,65%

¹⁰⁴

Sipas vendimeve të KSHZ-së nr. 09-1414/4 të datës 3 maj dhe 08-1769/1 të datës 11 maj. Përqindjet e votave për secilin kandidat janë llogaritur nga numri i përgjithshëm i votave të hedhura, duke i përfshirë votat e pavlefshme.

ANEKSI I: LISTA E VËZHguesVE NË MISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Asambleja Parlamentare e OSBE-së

Sereine	Mauborgne	Koordinatore e posaçme	Francë
Maximilian	Unterrainer	Deputet	Austri
Anne-Cecile	Blauwblomme-delcroix	Deputet	Francë
Inese	Ikstena	Deputet	Letoni
Igors	Aizstrauts	Deputet	Letoni
Arman	Teimouri	Deputet	Suedi
Ahmet	Arslan	Deputet	Turqi
Burak	Meydan	Anëtar stafi	Turqi
Hatice	Er As	Anëtar stafi	Turqi
Iryna	Sabashuk	Sekretariati	Ukrainë
Andreas	Baker	Sekretariati	Danimarkë

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

Marie-Christine	Dalloz	Kryesuese	Francë
Joseph	O'reilly	Deputet	Irlandë
Florence	Ganoux	Komisioni i Venedikut	Francë
Chemavon	Chahbazian	Sekretariati	Armeni
Daniele	Gastl	Sekretariati	Francë

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së ODIHR-it

Tobias	Burghardt	Austri
Matthias	Pühringer	Austri
Agnes	Taibl	Austri
Milutin	Jokiq	Bosnjë dhe Hercegovinë
Ivaylo	Kashkanov	Bullgari
Margarita	Nikolova-Ivanova	Bullgari
Svetlana	Stamenova	Bullgari
Jette	Egelund	Danimarkë
Thomas	Frank	Danimarkë
Kirsten	Joergensen	Danimarkë
Poul	Lauritsen	Danimarkë
Tue	Magnussen	Danimarkë
Kirsten	Mogensen	Danimarkë
Jørgen	Poulsen	Danimarkë
Christoffer	Bonn	Finlandë
Karita	Immonen	Finlandë
Melissa	Diagne	Francë

Catherine	Greze	Francë
Guillaume	Javourez	Francë
Véronique	Lasserre-fy	Francë
Ambroise	Mazal	Francë
Michel auguste	Rivollier	Francë
Claudio	Serafini	Francë
Christel Marie-Claude	Thibault	Francë
Valerie	Adams	Gjermani
Ulrike	Bickel	Gjermani
Thomas	Doehne	Gjermani
Matthias	Dornfeldt	Gjermani
Frank	Fischer	Gjermani
Thomas	Froehlich	Gjermani
Henning	Horstmeyer	Gjermani
Anke	Kerl	Gjermani
Bernd	Leber	Gjermani
Oliver	Pahnecke	Gjermani
Claudia	Preusser	Gjermani
Faik Yanki	Puersuen	Gjermani
Hildegard	Rogler-Mochel	Gjermani
Eckart	Rohde	Gjermani
Alexandra	Dobolyi	Hungari
Tibor	Kőszegvári	Hungari
Kartal	Kovalovszki	Hungari
Teresa	Doherty	Irlandë
Brendan	Gogarty	Irlandë
Elizabeth	Spelman	Irlandë
Maria	Alcidi	Itali
Paolo	Carlotto	Itali
Walter	Citti	Itali
Alessandro	Giongo	Itali
Elsa	Pacella	Itali
Alessia	Riva	Itali
Miljana	Rakoçeviq	Mali i Zi
Vana	Vojinoviç	Mali i Zi
Egbertus	Bom	Holandë
Leonardus Wilhelmus	Den biggelaar	Holandë
Maria Johanna Josefa	Lucas	Holandë
Christina	Van hout	Holandë
Rune	Hauger	Norvegji
Gent	Ramadani	Norvegji
Nils Gunnar	Songstad	Norvegji
Mariana	Ionescu	Rumani
Nikola	Jeliq	Serbi
Jovana	Presic	Serbi

Eva	Mašánová	Slovaki
Carlos-Maria	De Ceron y Castro	Spanjë
Ana	Hernández Rodríguez	Spanjë
Xira	Ruiz Campillo	Spanjë
Lars	Bjorklund	Suedi
Maj	Gustafsson	Suedi
Lennart	Haggren	Suedi
Kajsa	Ljungberg	Suedi
Stina	Magnuson Buur	Suedi
Helena	Munther	Suedi
Kajsa	Norman	Suedi
Ruth	Bourke Berglund	Suedi, Irlandë
Bernhard	Albrecht	Zvicër
Shumit	Chanda	Zvicër
Daniele	D'Esposito	Zvicër
Diana	Ferrari	Zvicër
Monica	Giambonini	Zvicër
Dally	Hakem	Mbretëri e Bashkuar
David	Harrison	Mbretëri e Bashkuar
Christopher	Jones	Mbretëri e Bashkuar
Ben	Jones	Mbretëri e Bashkuar
Paula	Keaveney	Mbretëri e Bashkuar
Melanie	Leathers	Mbretëri e Bashkuar
Roy	Martin	Mbretëri e Bashkuar
John	Mills	Mbretëri e Bashkuar
Valerie	Solomon	Mbretëri e Bashkuar
Guy	Summers	Mbretëri e Bashkuar
Alison	Sutherland	Mbretëri e Bashkuar
David	Taylor	Mbretëri e Bashkuar
Susan	Trinder	Mbretëri e Bashkuar
Jonathan	Turner	Mbretëri e Bashkuar
Keith	Turner	Mbretëri e Bashkuar
Joseph	Worrall	Mbretëri e Bashkuar
Sairah	Akhtar-Zaidi	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Deborah	Alexander	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Karolis	Butkevicius	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Paul	Calbos	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kyle	Bowers	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Michael	Eldred	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Michael	Forster Rothbart	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nina louise	Frankel	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andrew	Gridinsky	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert Scott	Heaslet	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Stephen	Hemphill	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marsha	Kennedy	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Matthew	Kennis	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nicholas	La Strada	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Aubrey	Menarndt	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Brooke	Nagle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Urania	Petit	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Octavius	Pinkard	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Azita	Ranjbar	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Michael	Schuetz	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Gregory	Slotta	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jenny	Sowry	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andreea	Vesa	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Daniel	Villegas	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
John	Winters	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë

Ekipi kryesor i MVZ-së së ODIHR-it

Corine	Jonker	Shefe e Misionit	Holandë
Vasil	Vashchanka		Bjellorusi
Kseniya	Dashutina		Bjellorusi
Monica	Moravcová		Republika Çeke
Marcela	Mašková		Republika Çeke
Valeriu	Mija		Moldavi
Max	Bader		Holandë
Tomasz	Jańczy		Poloni
Ranko	Vukčević		Serbi
Ivan	Godársky		Slovaki
Robert	Bystricky		Slovaki
Ruslan	Ovezdurdyev		Turkmenistan
Liudmyla	Shkirko		Ukrainë
Peter	Palmer		Mbretëri e Bashkuar

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it

Poul	Svane	Danimarkë
Irmeli	Vieno	Finlandë
Sabrina	Rouigui	Francë
Galina	Diran	Gjermani
Wolfgang	Graf von Schmettau	Gjermani
Paolo	Pagotto	Itali
Chiara	Steindler	Itali
Darko	Pavlović	Holandë
Vida	Koren Holm	Suedi
Lars	Tollemark	Suedi
Thomas	Hug	Zvicër

Thomas	Holzer	Zvicër
Andreas	Speiser	Zvicër
Wiktorija	Wislowska	Ukrainë
Mitchell	Polman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Patrick	Reilly	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

RRETH ODIHR-IT

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Kjo pjesë njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, për t'i përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 150 të punësuar.

ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me përkushtime e OSBE-së, obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin kombëtar. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e **demokratizimit** përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilët synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin obligimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale** që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e **tolerancës** dhe të **mosdiskriminimit**, ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikën e tyre që kanë të bëjnë me **romët dhe sintit**. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe të sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihr).